

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5571
E shtunë, 8 shtator 2018
çmimi 0.40 €

Impakti i ndryshimeve
gjeopolitike në pozitën
ndërkombëtare
të Kosovës | FAQE 6-7

Prof. dr.
Blerim REKA



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**SYNETIA E
HASHIM THAÇIT
PËRMES
'KORRIGJIMIT
TË KUFIJVE'
ME SERBINË!** F. 11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**KURTI KËRKON NGA TIRANA
TË DALË KUNDËR IDESË SË
THAÇIT** F. 5

**KOMUNA E PRIZRENIT
PËRKRAH FERMERËT PËR
NGRITJEN E 50 SERAVE** F. 8

EKONOMI

**DOGANA E KOSOVËS INKASOI
736.4 MILIONË EURO** F. 9

**REÇICA UA DORËZON
PENSIONISTËVE TË
DHËNAT ZYRTARE
TË VITEVE 1990-1998** F. 9

KULTURË



PUNËMBARI BISLIM PIREVA F. 13

Shkruan: Prof. dr. Hysen MATOSHI

SPORT

**KOSOVA DEBUTON ME
BARAZIM NË LIGËN E
KOMBEVE** F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISA MUSTAFA | FAQE 4-5

Opozita duhet të bashkëpunojë për ta çuar vendin në zgjedhje të reja

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se partitë opozitare duhet të bashkëpunojnë ndërmjet vete për ta krijuar rrugën që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se LDK-ja do të bashkëpunojë me Lëvizjen Vetëvendosje për

zgjedhje të reja dhe për qeverisje të mirë të vendit. Mustafa ka theksuar se ky koalicion qeverisës është duke e dëmtuar vendin dhe po rrezikon stabilitetin buxhetor. Ai ka thënë se Kuvendi nuk po funksionon në rrethana normale, kurse Qeveria po merr vendime arbitrare. Mustafa ka folur edhe për veprimet që po ndërmerr deputetja Teuta Rugova

në favor të kësaj qeverie. Ai ka thënë se deputetja Rugova duhet t'ia sqarojë vetvetes se çfarë përfaqëson në Kuvendin e Kosovës. "Ajo është deputete e LDK-së dhe e asnjë liste tjetër", ka thënë Mustafa. Duke e komentuar idenë për korrigjimin e kufijve, ai ka thënë se idetë e tilla janë të rrezikshme

PËRFAQËSUESJA E LARTË E BASHKIMIT EVROPIAN, FEDERICA MOGHERINI, KA TAKUAR TË PREMTEN NË TAKIME TË NDARA PRESIDENTIN E KOSOVËS DHE ATË TË SERBISË

Shtyhet takimi Thaçi - Vuçiq, thellohen mospajtimet

Nuk është mbajtur të hënën në Bruksel takimi i pritur ndërmjet presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe atij të Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në mungesë të këtij takimi, përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, ka zhvilluar vetëm takime të ndara me të dy presidentët. Pas takimeve ajo ka deklaruar se pret që presidentët do të tregohen të përkushtuar për arritjen e marrëveshjes paqësore dhe ligjërish të obligueshme. Sipas saj, takimi i përbashkët është shtyrë për fund të muajit | FAQE 3



**Bahtiri:
Situata e
sigurisë
në
Mitrovicë
është
shumë
e mirë** | FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rama fillon ndryshimet në qeveri

Tiranë, 7 shtator - Edi Rama të premten mbajti një fjalim të fortë në formë kritike ndaj strukturave të PS-së, të cilat janë kthyer në zyra emërimi pune në shtet e kudo që shkon ata të kërkojnë jo rrugë, drita apo rend, por vetëm vende pune në shtet. Fill pas kësaj, kryeministri, nga Asambleja e PS-së, përjashtoi nga radhët e PS-së deputetin Gjetan Gjetanin që, sipas kryeministrit, bën presion për ta emëruar shefin e komisarariatit, sikurse e ka kthyer zyrën e tij në zyrë emërimesh në shtet.

Kryeministri i ktheu përgjigje edhe liderit të opozitës, Lulzim Basha, i cili kërkon vetting për politikanët, ku Rama i kujtoi atij se do ta kontrollojnë jo vetëm Lulin, por edhe kunatin e tij. Po kështu theksoi se PS-ja do ta votojë projektligjin e sjellë nga PD-ja për vetting politik, duke filluar nga ai vetë, pra Rama dhe familja e tij. Por prapë nuk ndenji pa i kujtuar Berishës se kontrolli (vettingu) që ka sjellë Luli do ta digte Berishën. Nënkuptimi ishte për të birin e ish-kryeministrit, thonë burimet nga selia

kryeministore. Edi Rama në fund bëri ndryshimet e para në qeveri. Kush do të kuptojë apo që një statutin e PS-së e di se kur emërohet në një detyrë të tillë në kryesinë e PS-së nuk mund të mbash edhe post qeveritar. Pra, zëvendëskryeministria Senida Mesi u zgjodh sekretare e burimeve njerëzore në selinë rozë, çka nënkupton se filluan ndryshimet në qeveri, pa zhurmë, por po bëhen. Në vend të saj do të zgjedhë një tjetër, e cila, siç përfillet,



do të jetë një femër e njohur nga radhët e PS-së. Por, nuk dihet se ku mbarojnë ndryshimet në qeveri,

pasi sapo e nisi me numrin dy në qeveri. Emrat, me sa duket, i kanë të gjithë me laps.

Bahtiri: Situata e sigurisë në Mitrovicë është shumë e mirë

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri dhe komandanti i Batalionit Rajonal të KFOR-it për veriun e Kosovës, nënkolonel Ervin Hartman, kanë biseduar të premten për situatën e përgjithshme të sigurisë në këtë qytet. Bahtiri ka thënë se situata e sigurisë në Mitrovicë është shumë e mirë



EPOKA ERE Arbisa SHEFKIU

MITROVICË, 7 SHTATOR - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të premten në takim komandantin e Batalionit Rajonal të KFOR-it për Veriun e Kosovës, nënkolonel Ervin Hartman, me të cilin ka biseduar për situatën e përgjithshme të sigurisë që po mbretëron në qytetin e Mitrovicës, duke vazhduar më pas edhe me diskutime të tjera rreth ekonomisë në vendin tonë. Kryetari i komunës ka falënderuar komandantin e KFOR-it për kontributin e tij dhe të ushtarëve të tij për Mitrovicën, ku tha se falë angazhimit të drejtuesve të komunës dhe mbështetjes të parzshme të KFOR-it dhe të institucioneve të tjera vendore dhe ndërkombëtare, situata e sigurisë në

Komunën e Mitrovicës është shumë më e mirë dhe ka shkuar drejt një stabilizimi të plotë. "Kemi punuar shumë, bashkë me drejtuesit e komunës në veri të qytetit, që situata e sigurisë, lëvizja dhe qarkullimi i lirë i njerëzve dhe mallrave, si dhe raportet ndëretnike të përmirësohen. Falë kësaj pune, por edhe komunikimit, bashkëpunimit dhe mbështetjes që kemi pasur nga komandanti i paqeruajtësve të KFOR-it për veriun e Kosovës, sot në tërë Mitrovicën kemi një situatë shumë më të relaksuar, e cila po shkon me hapa të sigurt drejt stabilizimit të plotë", ka thënë ai. Po ashtu, kryetari Bahtiri ka diskutuar edhe në lidhje me bisedimet që po bëhen në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se e mbështet dialogun, pasi vetëm me dialog mund të shkojmë përpara,

mirëpo ka bërë të qartë se aty nuk duhet të flitet asnjëherë për shkëmbim të territoreve. Ndërkaq komandanti i KFOR-it, nënkolonel Ervin Hartman, ka pohuar se ndihet mirë kur dëgjon për përparime në përmirësimin e situatës së sigurisë në komunë, si dhe për punën e mirë që po bëhet në zhvillimin ekonomik të saj. "Mendoj se prania e KFOR-it këtu është mjaft e rëndësishme për qytetarët dhe komunën tuaj.

Gëzohem që keni pasur komunikim dhe bashkëpunim të mirë me pjesëtarët e KFOR-it, gjë që ka rezultuar me stabilizimin e gjendjes së përgjithshme, përmirësimin e komunikimit ndërmjet komuniteteve dhe lëvizjen e qarkullimit të lirë të qytetarëve dhe të mallrave. Unë do të angazhohem maksimalisht që bashkëpunimin dhe komunikimin me ju ta thellojmë", ka thënë ai. Po ashtu, nënkolonel

Ervin Hartman ka theksuar se stabilizimi i plotë i gjendjes së sigurisë në qytetin e Mitrovicës dhe krijimi i kushteve për lëvizje e qarkullim të lirë do të jetë kusht për t'i përmirësuar raportet ndëretnike. "Andaj do të punojmë sërish së bashku në mënyrë që të kemi një zhvillim të mirëfilltë ekonomik dhe ta përmirësojmë dukshëm cilësinë e jetesës së njerëzve këtu", ka thënë Hartman.

Basha: Vetingu për politikanët, si ai për prokurorët dhe gjyqtarët

TIRANË, 7 SHTATOR - Partia Demokratike ka gati Projektligjin me amendamentet për vetingun e politikanëve që janë njësoj si për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe tani është radha e mazhorancës ta tregojë veten nëse do ta votojë apo jo. Kryetari i PD-së, Lulzim Basha, deklaroi të premten, në një

bashkëbisedim me gazetarët, se situata kriminale në vend ka vërtetuar të gjitha paralajmërimet e Partisë Demokratike bërë deri më sot. I pyetur nëse do të bashkëpunojë me Ramën, pasi ky i fundit e pranoi propozimin për vetingun e politikanëve, Basha tha se "ky ligj është negociuar njëherë. Gjuha e ligjit është

njësoj si për gjyqtarët, edhe për prokurorët dhe negociatat bëhen për një tekst të dakordësuar. Kjo, ose vonohet, ose refuzohet. Opozita ka marrë një vendim në Elbasan për ta votuar. Ramën pyeteni nëse do ta votojë, apo do ta pengojë". "Propozimi për vetingun e politikanëve është njësoj si për gjyqtarët dhe

prokurorët, madje edhe për policët. Propozimi është depozituar. Ne do të shkojmë për ta votuar. Ramën pyeteni nëse do ta votojë për apo kundër", theksoi Basha. "Është atentat ndaj demokracisë që sot kemi politikanët të lidhur me krimin. Çyben e Xhafajn. Në Parlament Ballën. Në krye të Elbasanit,



Sejдинin. Në Durës, Dakon. Për këtë ka vetëm një zgjidhje, veting i politikanëve", tha Basha.

Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka takuar të premtën në takime të ndara presidentin e Kosovës dhe atë të Serbisë

Shtyhet takimi Thaçi - Vuçiq, mospajtimet thellohen



Nuk është mbajtur të hënën takimi i pritur ndërmjet presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe atij të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel. Në mungesë të këtij takimi, përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, ka zhvilluar vetëm takime të ndara me të dy presidentët. Pas takimeve, ajo ka deklaruar se pret që presidentët do të tregohen të përkushtuar në arritjen e marrëveshjes paqësore dhe ligjërish të obligueshme. Sipas saj, takimi i përbashkët është shtyrë për fund të muajit

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Ka dështuar takimi ndërmjet presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në Bruksel, i cili ishte paraparë të ndodhë të premtën. Mosmbajtja e takimit ka ndodhur për shkak se autoritetet e Kosovës nuk i kanë dhënë leje presidenti serb që gjatë qëndrimit të planifikuar për të shtunën në Kosovë, ta vizitojë edhe liqenin e Ujmanit. Në vend të takimit të përbashkët, përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka zhvilluar vetëm takime të ndara me të dy presidentët. Ajo ka shprehur bindjen se të dy presidentët do të tregohen të përkushtuar për arritjen e marrëveshjes paqësore dhe ligjërish të obligueshme. "Në kontekstin e dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja midis Beogradit dhe Prishtinës, unë prita sot presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe presidentin e Kosovës, Hashim

Thaçi, në Bruksel. Kam mbajtur disa raunde bisedimesh në formatin bilateral për të gjitha çështjet në tryezë. Vështirësitë mbeten. Unë besoj në përkushtimin e plotë të të dy presidentëve për ta vazhduar procesin dhe për të arritur në muajt e ardhshëm një marrëveshje ligjërish të detyrueshme për një normalizim të plotë të marrëdhënieve, në përputhje me ligjin ndërkombëtar", ka thënë Mogherini pas këtyre takimeve. Ajo ka bërë me dije se takimi i planifikuar do të shtyhet për në fund të këtij muaji. "Unë do ta mbledh në Bruksel sesionin e ardhshëm të nivelit të lartë të dialogut para Javës Ministrore të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (që mbahet më 18 shtator) për t'i bërë bashkë të dyja palët për të çuar përpara punën në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjes", është thuhet në deklaratën e Mogherinit.

Pas takimit me Mogherinin, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se në takimin me përfaqësuesen e lartë të BE-

së është diskutuar për mundësinë e arritjes së përparimeve. Ai ka deklaruar se mungesa e takimit me presidentin serb dëshmon se vështirësitë po shtohen kur është në pyetje arritja e marrëveshjes me Serbinë. "Gjërat po bëhen edhe më të vështira sepse mospajtimet po thellohen, kurse dallimet po shfaqen, edhe pse sot kemi diskutuar vetëm përmes zonjës Mogherini. Por, këto dallime të mëdha kanë ndikuar që sot dialogu të zhvillohet vetëm përmes përfaqësueses së lartë të BE-së", ka thënë Thaçi, duke shtuar se arritja e marrëveshjes mbetet vetëm si një gjasë teorik. Pavarësisht prej këtyre vështirësive, shefi i shtetit është shprehur i gatshëm për vazhdimin e dialogut. "Vështirësitë janë të mëdha, pengesat janë të mëdha dhe dallimet janë shumë të thella, por rrugëtimi dhe dialogu për paqe, stabilitet e fqinjësi të mirë nuk ka alternativë", ka deklaruar presidenti i Kosovës. Ai ka rikujtuar se konflikti ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ka një

kohëzgjatje prej një shekulli, kështu që parashikoi proces shumë të vështirë deri te arritja e marrëveshjes paqësore.

Presidentin Thaçi ka folur edhe për arsyet se pse presidenti serb nuk ka pranuar të takohet me të sot. Sipas tij, vizita e zyrtarëve serbë në Kosovë do të ndodhin vetëm sipas itinerarit të lejuar. "Kosova i ka institucionet e veta kredibile. Jemi vend i pavarur e sovran dhe do të respektohet itinerari i lejuar për vizitën e presidentit të Serbisë në territorin e Kosovës. As më pak e as më shumë. Ne respektojmë secilin, nuk dëshirojmë të poshtërojmë askënd, por do ta mbrojmë sovranitetin e Kosovës", ka deklaruar Thaçi. Ndërsa shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, ka treguar në hollësi për refuzimin e presidenti serb që të takohet me presidentin e Kosovës. "Për shkak të kërcënimeve, sulmeve, shantazheve, si dhe tentimeve që t'i ndalohet vizita në veri të Kosovës dhe te Liqeni i Ujmanit nga ana e autoriteteve të Kosovës", ka thënë ai. Madje, sipas tij, kjo ka vënë në pikëpyetje vazhdimin e bisedimeve me Kosovën.

Gjithashtu, Gjuriq ka theksuar se janë të papranueshme tentimet e që të zhvlerësohen bisedimet në Bruksel dhe tentimet, siç ka thënë ai, që Presheva, Medvegja dhe

Bujanoci të paraqiten si pjesë e territorit të Kosovës. "Çështje e vetme e pazgjidhur, territori i vetëm për të cilin bisedohet dhe kontestohet është çështja e territorit të Kosovës. Gjithçka tjetër nuk shërben për asgjë tjetër, përveçse ta shembë gjithë procesin", ka thënë Gjuriq. Ai ka treguar se presidenti i Serbisë do t'i drejtohet opinionit të premtën në mbrëmje, ku edhe do ta bëjë të ditur nëse do ta realizojë vizitën në Kosovë, të paralajmëruar më herët.

Edhe ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili ka qëndruar në Bruksel në kuadër të delegacionit të Kosovës, ka thënë se autoritetet e Kosovës e kanë miratuar kërkesën e Vuçiqit për ta vizituar Kosovën, komunat e veriut. Por, sipas tij, presidenti serb nuk ka asnjë arsye ta vizitojë liqenin e Ujmanit. "Nuk dua të paragjykoj asgjë, por nuk shoh arsye pse duhet të vizitohet Ujmani në këtë fazë të dialogut që momentalisht ndodhemi. Nuk e di për çfarë arsye, sepse aty nuk ka asnjë qendër urbanistike. Çdo vizitë duhet ta ketë një arsye. Ne nuk shohim një të tillë. Nëse një kërkesë e veçantë bazohet në diçka, sigurisht se ne nuk do të jemi kundër. Nëse vizita është me qëllime të mira, ai është çdoherë i mirëseardhur", ka theksuar Pacolli para gazetarëve në Bruksel.

Flet për "Epokën e re", Isa Mustafa

Opozita duhet të bashkëpunojë për



Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se partitë opozitare duhet të bashkëpunojnë ndërmjet vete për ta krijuar rrugën që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se LDK-ja do të bashkëpunojë me Lëvizjen Vetëvendosje për zgjedhje të reja dhe për qeverisje të mirë të vendit. Mustafa ka theksuar se ky koalicion qeverisës është duke e dëmtuar vendin dhe po rrezikon stabilitetin buxhetor. Ai ka thënë se Kuvendi nuk po funksionon në rrethana normale, kurse Qeveria po merr vendime arbitrare. Mustafa ka folur edhe për veprimet që po ndërmerr deputetja Teuta Rugova në favor të kësaj qeverie. Ai ka thënë se deputetja Rugova duhet t'ia sqarojë vetvetes se çfarë përfaqëson në Kuvendin e Kosovës. "Ajo është deputete e LDK-së dhe e asnjë liste tjetër", ka thënë Mustafa. Duke e komentuar idenë për korrigjimin e kufijve, ai ka thënë se idetë e tilla janë të rrezikshme

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë të premten se idetë për korrigjim të kufijve dhe shkëmbim të territoreve janë të rrezikshme dhe të papranueshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se idetë e tilla mund të kenë pasoja vargore jo vetëm për Kosovën dhe qytetarët e saj, por edhe për vendet e tjera të Ballkanit. "Presidenti Thaçi nuk ka të drejtë ta promovojë korrigjimin e kufijve dhe shkëmbimin e territoreve, sepse me këtë po e shkel Kushtetutën. Për dialog ai duhet të ketë mandat të 2/3 të Kuvendit. Pa këtë mandat çdo marrëveshje është e paqëndrueshme dhe e pazbatueshme. Këtë duhet ta kenë parasysh

edhe z. Mogherini, Vuçiqi dhe BE-ja", ka deklaruar Mustafa. Sipas tij, marrëveshja e parë e nënshkruar nga Thaçi dhe as dokumenti i parimeve i nënshkruar nga Mustafa nuk i japin Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe kompetenca ekzekutive dhe të pushtetit të tretë. "E kam sqaruar se Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe iu kanë vënë themelet me marrëveshjen e parë të nënshkruara nga z. Thaçi atëherë kryeministër dhe e ratifikuar me mbi 2/3 nga Kuvendi i Kosovës. Për të qenë korrekt, duhet të shtoj se as marrëveshja e parë e nënshkruar nga Thaçi dhe as dokumenti i parimeve i nënshkruar nga unë nuk i japin Asociacionit kompetenca ekzekutive dhe të pushtetit të tretë. Deklaratat për këtë po jepen nga diletantë politikë, të cilët kanë mbetur në

lendinë, pasi LDK-ja nuk po i bashkëngjitet këtij dialogu me njerëz që nuk kanë legjitimitet politik dhe kushtetues. Republika Serpska e ministrit tonë të Drejtësisë dhe e mentorëve të tij duhet të parandalohet me marrëveshjen e re. Prandaj, këtu qëndron edhe sikleti i tyre!", ka theksuar ai.

Mustafa ka folur edhe për punën njëvjeçare të Qeverisë Haradinaj. Ai ka theksuar se ky koalicion qeverisës po e dëmton vendin dhe po e rrezikon stabilitetin buxhetor. Lideri i LDK-së ka vlerësuar se Kuvendi nuk po funksionon normalisht dhe se Qeveria po merr vendime arbitrare. "Kjo ka shkakuar që Kosova si shtet me sistem parlamentar të abuzohet nga presidenti dhe të duket se është shtet presidencial, sepse punët që duhet t'i ushtrrojë Qeveria dhe Kuvendi në mënyrë

ta çuar vendin në zgjedhje të reja

përkrahje të madhe të bashkëpunëtorëve të mi. Koalicioni qeverisës po të ishte i mençur, një orë e më parë do ta shpërndante Kuvendin dhe do të shkonte në zgjedhje të reja. Çdo ditë e qeverisjes së këtij koalicioni është në dëm të vendit dhe në dëm të tyre. Ky koalicion qeverisës është duke e dëmtuar vendin në skenën ndërkombëtare, po e rrezikon stabilitetin makroekonomik dhe buxhetor, e ka kanonizuar Qeverinë mbi baza të intereseve, është i varur nga Lista Serbe e cila diktohet nga Beogradi. Kuvendi nuk funksionon normalisht, kurse Qeveria merr vendime arbitrare për të cilat më vonë do të ketë probleme ligjore. Kjo ka shkakuar që Kosova si shtet me sistem parlamentar të abuzohet nga presidenti dhe të duket se është shtet presidencial, sepse punët që duhet t'i ushtrojë Qeveria dhe Kuvendi në mënyrë jokushtetuese po i ushtron presidenti i vendit.

"Epoka e re": Jeni i kënaqur me rolin e opozitës në përgjithësi dhe të LDK-së, partisë që drejtoni?

Mustafa: Roli i opozitës është i faktorit korrektues. Këtë po e bën grupi parlamentar i LDK-së. Nganjëherë edhe po i ngatërrojme adresat, sepse opozita jonë është në Kuvend, ajo i referohet Qeverisë dhe qeverisjes së vendit; mënyrës se si po drejtohet Kuvendi dhe si po shkelen procedurat parlamentare. Si pasojë e disa inateve të së kaluarës, por edhe e arbitrarisht të presidentit në raport me dialogun, nganjëherë fitohet përshtypja se më shumë merremi me të sesa me ata që po e qeverisin vendin. Duhet të bashkëpunojmë me partitë e tjera të opozitës, por edhe të pozitës për të shkuar në zgjedhje të reja.

"Epoka e re": Nga këndvështrimi juaj, si i keni parë dhe si i komentoni zhvillimet e fundit në skenën politike?

Mustafa: Skena politike është fyese dhe komprometuese për qytetarët e Kosovës, por edhe para opinionit ndërkombëtar. Në dhjetë vjetët e fundit gjendemi në fazën më të ashpër të mosbesimit të ndërsjellë ndërmjet pozitës dhe opozitës, të mungesës së besimit dhe të bashkëpunimit. Është pasojë e makinacioneve të PDK-së dhe të kryetarit aktual të saj. Tani partitë shqiptare në pozitë nuk janë të vetëdijshme se janë në pakicë dhe se kanë mbetur në mëshirën e Listës Serbe.

"Epoka e re": Nuk kemi parë një qëndrim tuajin sa i përket veprimeve të deputetes së LDK-së, vajzës së ish-presidentit Rugova, Teutës, e cila në disa raste po del të jetë shpëtimtare për këtë koalicion qeverisës. A do të marrë ndonjë masë LDK-ja?

Mustafa: Para së gjithash, deputetja Rugova duhet t'ia sqarojë vetvetes se çfarë përfaqëson në Kuvendin e Kosovës. Ajo është deputete e LDK-së dhe e asnjë liste tjetër. E kemi përfshirë në listën tonë dhe e kemi përkrahur si vajzë të re dhe, si e tillë, ka marrë vota dhe besimin qytetar. Ndërkaq, LDK-ja nuk mund të diktohet nga jashtë se si duhet të sillemi ndaj deputetëve tanë.

"Epoka e re": Aktualisht vendi po ballafaqohet me idenë për korigjimin e kufirit në mes të Kosovë dhe Serbisë, ide kjo e prezantuar nga presidenti Hashim Thaçi. Çfarë qëndrimi keni për këtë? Dhe si e shihni ecurinë e dialogut tash e tutje?

Mustafa: I shohim të rrezikshme dhe të papranueshme idetë për korigjim të kufijve dhe shkëmbim të territoreve. Idetë e tilla, që më parë janë promovuar nga qarqe nacionaliste dhe luftënxitëse në Serbi për kufij etnikë, por edhe nga individë të tjerë për marrëveshje shqiptaro-serbe, mund të kenë pasoja vargore jo vetëm për Kosovën dhe qytetarët e saj, por edhe më gjerë në vendet e Ballkanit. Presidenti Thaçi nuk ka të drejtë ta promovojë korigjimin e kufijve dhe shkëmbimin e territoreve, sepse me këtë po e shkel Kushtetutën. Për dialog ai duhet të ketë mandat të 2/3 të Kuvendit. Pa këtë mandat çdo marrëveshje është e paqëndrueshme dhe e pazbatueshme. Këtë duhet ta kenë parasysh edhe z. Mogherini, Vuçiqi dhe BE-ja.

"Epoka e re": Ish-bashkëpunëtorët tuaj në koalicionin qeverisës po ju akuzojnë se ju jeni fajtor për nënshkrimin e marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe për të cilin po thuhet se do të ketë kompetencat ekzekutive, me të cilat veriu do të përfitojë një lloj autonomie.

Mustafa: Kam sqaruar se Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe iu kanë vënë themelet me marrëveshjen e parë të nënshkruara nga z. Thaçi, atëherë kryeministër dhe e ratifikuar me mbi 2/3 nga Kuvendi i Kosovës. Gjykata Kushtetuese, duke e trajtuar dokumentin e parimeve për këtë Asociacion, të nënshkruar

nga unë, ku ka marrë pjesë edhe z. Thaçi si zëvendëskryeministër, ka konstatuar se Asociacioni duhet të themelohet sipas marrëveshjes së parë dhe Ligjit për ratifikimin e marrëveshjes së parë. Për të qenë korrekt duhet të shtoj se as marrëveshja e parë e nënshkruar nga Thaçi dhe as dokumenti i parimeve i nënshkruar nga unë nuk i japin Asociacionit kompetenca ekzekutive dhe të pushtetit të tretë. Deklaratat për këtë po jepen nga diletantë politikë, të cilët kanë mbetur në lëndinë, pasi LDK-ja nuk po i bashkëngjitet këtij dialogu me njerëz që nuk kanë legjitimitet politik dhe kushtetues. E kam sqaruar publikisht se sa i përket dokumentit të parimeve që unë e kam nënshkruar, para se të shkoj në Bruksel për nënshkrimin e tij, kam kërkuar dhe kam marrë me shkrim zotimet e përfaqësuesve më të lartë të BE-së se Asociacioni sipas kënd-

vështrimit të tyre nuk do të ketë kompetenca ekzekutive dhe të pushtetit të tretë. Republika Serpska e ministrit tonë të drejtësisë dhe e mentorëve të tij duhet të parandalohet me marrëveshjen e re. Prandaj këtu qëndron edhe sikleti i tyre!

"Epoka e re": Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, edhe publikisht ju ka ftuar të bashkëpunonin dhe të merrni pjesë në protesta, të cilat, sipas tij, kanë për qëllim mbrojtjen e territorit dhe largimin e presidentit Thaçi. Cili është qëndrimi i LDK-së për këtë bashkëpunim me LV-në, kur dihet se kjo parti, sa ishit kryeministër, ju sulmonte, madje edhe te shtëpia juaj?

Mustafa: Ne do të bashkëpunojmë me Vetëvendosjen dhe me subjektet e tjera për çështje të tjera, për të krijuar kushte për zgjedhje të reja dhe për qeverisje të mirë të vendit.



Kurti kërkon nga Tirana të dalë kundër idesë së Thaçit

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, është takuar të premtën me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Në këtë takim Kurti ka shpjeguar qëndrimet e Vetëvendosjes në raport me zhvillimet më të fundit politike në Kosovë, të cilat, sipas tij, kanë nxjerrë në pah rrënimin e demokracisë në vend përmes bllokimit që Qeveria i ka bërë Kuvendit të Kosovës dhe dialogut të gabuar e pa parime me Serbinë që po zhvillon një president i papërgjegjshëm si Thaçi. "Në takim u theksua nevoja që Tirana zyrtare të

shprehet hapur kundër manovrave manipulative që po ndërmer Hashim Thaçi, të cilat rrezikojnë të copëtojnë dhe degradojnë shtetin e Kosovës, me pasoja për gjithë kombin shqiptar, në shpërputhje me vullnetin e popullit dhe të shumicës shqiptare të deputetëve në Kuvendin e Kosovës. Kosova ka nevojë të forcohet e konsolidohet si shtet ekonomikisht, politikisht dhe ushtarakisht, duke u orientuar nga Republika e Shqipërisë për t'i hequr të gjithë llojet e kufijve që po na mbajnë të ndarë", është thënë në njoftimin e Vetëvendosjes.

jokushtetuese po i ushtron presidenti i vendit", është shprehur Mustafa, duke shtuar se ky koalicion, po të ishte i mençur, një orë e më parë do ta shpërndante Kuvendin dhe do të shkonte në zgjedhje të reja. Ai ka paralajmëruar bashkëpunim me Lëvizjen Vetëvendosjen për të krijuar kushte për zgjedhje të reja dhe për qeverisje të mirë të vendit.

"Epoka e re": Z. Mustafa, pas një pauze të gjatë, për shkak të problemeve shëndetësore, tashmë i jeni kthyer skenës politike. Çfarë vlerësimi keni për koalicionin qeverisës PAN, i cili këto ditë mbush një vit prej se ka ardhur në krye të shtetit?

Mustafa: Pjesërisht i jam kthyer skenës politike. Kam nevojë edhe një kohë për pushim më të madh dhe për rehabilitim. Po bashkërendis punët me

Impakti i ndryshimeve gjeopolitike në pozitën ndërkombëtare të Kosovës

- Paneli I: "Kosova si pjesë e zhvillimeve globale. Ndikimi i tyre në politikën e jashtme të Kosovës"



Prof. dr. Blerim REKA

Hyrje

Duke iu përmbajtur titullit të këtij paneli, në fjalën time do të përpiqem ta elaboroj ndikimin e ndryshimeve gjeopolitike të dekadës së fundit në pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe rrjedhimisht edhe në politikën e saj të jashtme.

Teza ime kryesore është se viti 2018 nuk është 2008-a e aq më pak 1999-a. Shkurti i vitit 2008 ishte treni i fundit për pavarësimin e Kosovës, sepse po atë muaj Rusia do ta fillonte rikthimin e madh në arenën ndërkombëtare. ShBA-ja do të tërhiqej lehtë nga Ballkani, BE-së do t'i dobësohej shtylla atlantiste, (me BREXIT) e do t'i forcohej ajo lindore me regjimet populiste.

Ashtu siç 24 marsi 1999 ishte çasti i fundit për çlirimin e Kosovës nga Serbia, po kështu 17 shkurti ishte i fundit për pavarësimin e Kosovës. Pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s, Rusinë e dobët të Jelcinit, do ta zëvendësojë Rusia e fortë e Putinit; sikur që disa muaj pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, po kjo Rusi do të fillonte t'i rikthejë pozicionet e humbura strategjike në Detin e Zi, Mesdhe dhe Ballkan. Ky ndryshim gjeopolitik, mbase shpjegon, pse në vitet e fundit ndodhi ndalja e njohjeve të reja ndërkombëtare për shtetin e Kosovës?

Globalisht, në dhjetë vjetet e fundit u shtuan tendencat militariste, me shtimin e buxheteve ushtarake të fuqive të mëdha, duke arritur sot nivelin më të lartë që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, në totalin prej 1,7 trilion dollarësh amerikanë.

Në një tubim si ky i sotmi këtu, javën e kaluar në Paris presidenti francez Makron, në

Konferencën e Ambasadorëve të Francës, kërkoi "autonomi strategjike për BE-në" apo, siç e quajti ai, një "Evropë sovranë në partneritet strategjik me Rusinë dhe Turqinë", ndërkaj Merkel, pas qëndrimeve të presidentit Trump në samitin e fundit të NATO-s, do të deklaronte se siguria evropiane më nuk mund të bazohet ekskluzivisht në ShBA-në.

Në Ballkan, ndërkaj, dekada e parë e shtetit të Kosovës kaloi në përplasjen për ndikim të Perëndimit në një anë dhe të tri fuqive lindore në anën tjetër: Rusi, Kinë dhe Turqi.

1. Rusia

Rrethanat gjeopolitike në përgjithësi dhe ato në Ballkan në veçanti, dhjetë vjet nga shpallja e pavarësisë, pra ndryshuan dukshëm.

Nga unipolariteti marrëdhëniet ndërkombëtare pas vitit 2008 rrëshqitën fillimisht në bipolaritetin e një lufte të re të ftohtë, (ShBA - Rusi), kurse së voni edhe në atë që tash po quhet multipolaritet (me Kinën si fuqi globale në ngritje).

Duket se fillimi i vitit 2008 ishte momenti i fundit për pavarësimin e Kosovës, sepse më vonë do të ndryshonte konteksti i përgjithshëm gjeopolitik. Po në muajin e sovranizimit shtetëror të Kosovës, në samitin e sigurisë së Munihut, Putini do ta inauguronte kthimin e madh rus në arenën ndërkombëtare me rikthimin e vokabularit të Luftës së Ftohtë sepse, siç do të shprehej aty: "Shpërbërja e ish-Bashkimit Sovjetik ishte gabimi më i madh gjeopolitik".

"Korrigjimi" praktik i këtij gabimi do të bëhej vetëm pas disa muajve me aneksimet në Gjeorgji (të Osetisë Jugore dhe Abkazisë) të Krimesë në vitin 2014, të Ukrainës Lindore në vitin 2015 dhe stacionimit ushtarak në Siri (2016). Perëndimi, pos reagimit verbal dhe ekonomik, nuk ndaloi marshimin e ri rus.

Si rrjedhojë, NATO-ja pezulloi pranimin e Gjeorgjisë, kurse BE-ja të Ukrainës. Në Siri, ndërkaj, Rusia rifuqizoi bazën e vetme në

Mesdhe, të vetmen që i mbeti nga Lufta e Ftohtë. Siç vëren me të drejtë Hedlund: "Pas zbarkimit të diplomacisë navale ruse, Mesdheu më nuk është liqeni i NATO-s pa flotën e gjashtë amerikane".

Me kombinimin e pretekstit për mbrojtjen e të drejtave të pakicave ruse në shtetet fqinje, me petrodollarin dhe propagandën e lajmeve të rrejshme, Rusia për një dekadë arriti të ripozicionohet globalisht si fuqi botërore.

Si eksportues kryesor i energjisë në tregun e BE-së, me të cilin mban 70 % të buxhetit të vet shtetëror, Rusia gjatë dhjetë vjetëve të fundit modernizoi ushtrinë dhe forcoi propagandën diplomatike.

Politika e jashtme ruse riktheu pozicionet e humbura në fillim të nëntëdhjetave në dy pika strategjike kyçe: në Detin e Zi dhe në Mesdhe, me përpjekjet për t'u afruar edhe të tretit - Adriatikut pas tentimeve të dështuara për grushtshtete në Mal të Zi (2016) dhe Maqedoni (2017).

Për dallim nga Ballkani Adriatik, ku nuk pati sukses, Rusia u pozicionua sigurt në Ballkanin kontinental, para së gjithash në Serbi dhe Republika Serbska.

Derisa në pjesën detare të gadishullit, NATO-ja nga muaji i kaluar mbylli krahun jugor të sigurisë me vendimin për ndërtimin e bazës ajrore në Kuçovë; Moskë vazhdoi të penetrojë ushtarakisht në Ballkanin qendror.

Pas vendosjes së bazës në Nish dhe armatosjes së Serbisë me avion lufte, muajin e kaluar filloi mbështetjen për krijimin e forcave të sigurisë në Republika Serbska. Pra, pas rikthimit në Kaukaz e Siri, Rusia u stacionua edhe në Ballkan sa më afër daljeve detare, (për në Egje dhe në Adriatik afër kufijve me Kosovën e Maqedoninë).

Rusia, sot, është shumë afër kufijve të Kosovës dhe ky faktor duhet pasur parasysh në projektimet e politikës së jashtme. Sidomos, pas retorikës së shpeshtuar mbi të ashtuquajturin "precedent të Kosovës", me të cilin Rusia vitet e fundit po tenton ta legalizojë aneksimin e Krimesë. Vetë Putini disa herë shtroi pyetje, nëse bota njohu të drejtën për vetëvendosje të Kosovës, pse nuk e njeh edhe të drejtën për vetëvendosje të Krimesë? Pavarësisht se janë këto dy raste të pakraha-

sueshme, nuk duhet përjashtuar tregtinë e madhe Kosovë - Krime midis ShBA-së dhe Ruisë, siç spekulohet para takimit të fundit Trump - Putin në Helsinki, ndonëse kjo zyrtarisht që mohuar.

Flitet se impakti i kësaj tregtie diplomatike mund të ishte tërheqja e sanksioneve të perëndimit kundër Ruisë me tërheqjen e vetos së saj në KS për anëtarësimin e Kosovës në KB. Pikërisht, kur objektivi i ShBA-së mbetet anëtarësimi i Kosovës në OKB, siç do të deklaronte kohë më parë zyrtari i lartë i Departamentit të Shtetit, Palmer.

2. Kina

Dekada e fundit nxori edhe forcimin global të Kinës si kontribuuesen në ekonominë botërore me 16 për qind. Jo se edhe para 2008-s Kina ishte e dobët, sidomos si anëtare e përhershme në KS të OKB-së, por jo në dimensionin aktual. Në gjysmën e kësaj dekade, pos zbarkimit politiko-ushtarak rus në Ballkan, filloi edhe aterrimi ekonomik kinez në rajon. Cak ishin limanet detare dhe korridoret rrugore e hekurudhore, si trampolinë mbështetëse infrastrukturore të eksportit të saj në tregun e BE-së. "Rruga e re e mëndafshit" është megaprojekti kinez që do ta afektojë edhe Ballkanin përmes iniciativës rajonale "16 + 1" të lansuar në vitin 2012 (me 11 shtete anëtare të BE-së dhe pesë të Ballkanit, pa Kosovën).

Për implementimin e tij, në vitin 2016 Kina do ta krijonte fondin prej 10 miliardë eurosh.

Ftohja kineze-amerikane pas luftës së fundit doganore afro Moskën dhe Pekinin, sidomos pas nënshkrimit të marrëveshjes shekullore mega-energjetike Rusi - Kinë (2016) apo të ashtuquajturin: "Partneriteti i Madh Euraziatik" ("A Great Eurasian Partnership"), ngaqë Kina mbetet konsumuesja më e madhe botërore e energjisë, njëkohësisht tregu më i madh për gazin rus, sidomos pas sanksioneve ekonomike dhe embargo energjetike perëndimore pas vitit 2014.

Derisa Rusia është e pranishme në Serbi politikisht e ushtarakisht, Kina vazhdon të jetë ekonomikisht, ku Beogradi mbetet përfituesi më i investimeve kineze, apo aq sa BE-ja investoi për tërë rajonin.

Pos kësaj pranie ekonomike, Kina mbetet edhe aleate politike e Serbisë, së paku që nga viti 1999, nga bombardimet e NATO-s. Andaj projeksionet e politikës së jashtme të Kosovës duhen pasur parasysh edhe këtë lojtar të dytë të madh global, i cili, po si Rusia, nuk e ka njohur Republikën e Kosovës dhe mban të drejtën e vetos në KS të OKB-së.

3. Turqia

Lojtarja e tretë e cila gjatë dekadës së fundit multipolarizoi influencën e huaj në Ballkan ishte Turqia me penetrimin kulturor dhe ekonomik. Programet kulturore të bazuara në trashëgiminë pesëshkullore osmane dhe prania e kompanive turke, e imponuan Ankarën si fuqi rajonale nga Sarajeva e deri në Tiranë. Me përjashtim të Malit të Zi, nuk ka shtet në rajon që nuk ka marrëdhënie miqësore bilaterale ndërshtetërore me Ankarën. Pas afrimit strategjik turko-rus dhe atij ruso-kinez, ndryshoi edhe mozaiku i lojtarëve ndërkombëtarë në Ballkan. Në veçanti pas marrëveshjes për partneritet strategjik Rusi-Turqi-Iran (2017), pas rikthimit të sanksioneve ekonomike amerikane ndaj Iranit dhe tërheqjes së ShBA-së nga marrëveshja nukleare me Iranin.

Së voni edhe pas luftës së fundit tregtare ShBA - Turqi (gusht 2018). Afrimi ruso-turk dhe turko-iranian në dy vjetet e fundit, pos në rrafshin ekonomik, mund t'i sfidojë edhe raportet bilaterale ShBA - Turqi, edhe në lëmin e sigurisë deri tek sfidimi i anëtarësisë së kësaj të fundit në NATO.

4. Çfarë politike të jashtme për Kosovën?

Zhvillimet e tilla globale gjatë dekadës së fundit dhe influencimi i tyre në Ballkan, ndau rajonin në dy sfera të interesit strategjik, në Ballkanin Adriatik pro-perëndimor (me Shqipërinë, Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë) dhe Ballkanin Danubian proruss (me Serbinë e Republika Serbska).

Bosnja e Hercegovina, e dërrmuar konstitucionalisht e institucionalisht përbrenda dhe e bllokuar jashtë nga vetoja e Banjallukës në politikën e jashtme, mbeti e ndarë midis Ruisë (Republika Serbska) dhe

Turqisë dhe Arabisë Saudite (Federata Boshnjake).

Bazuar në zhvillimet e lartpërmendura ndërkombëtare, duhet analizuar ndikimin e tyre në pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe mbi bazën e kësaj analize të projektohet një politikë e jashtme e saj.

Në Ballkan dhe në vitet në vijim, pritet vazhdimi i kësaj përplasjeje të ndikimeve strategjike. Status-quoja e gjertanishme 15-vjeçare e zgjerimit e Bashkimit Evropian në Ballkan vetëm sa joshi lojtarët e tjerë strategjikë për ta forcuar praninë e vet rajonale. Pas mungesës së gjatë në rajon, NATO-ja dhe BE-ja duhet të rikthehen në mënyrë më proaktive. Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO do ta bënte praktikisht që Kosova të kufizohet me NATO-n (Maqedoni, Shqipëri, Mali i Zi) pos kufirit me Serbinë. Pos sigurisë së ¾ të kufijve të saj nga aleanca veriatlantike, bërja e Maqedonisë shtet i 30 i NATO-s do ta mbyllte atë që Kopa e quan "vrëmën e zezë të influencës ruso-turke në Ballkan".

Pesë vjetët e dialogut të Brukselit nuk arritën cakun e përcaktuar: normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Vazhdimi i kësaj amullie negociuese vetëm do ta përmbushte planin e Beogradit për mbajtjen e Kosovës si konflikt të ngrirë: sa më gjatë jashtë OKB-së; me sa më pak njohje të reja dhe me pozitë sa më të

dobët ndërkombëtare.

Prandaj, politika e jashtme e Kosovës duhet ta parandalojë skenarin e konfliktit të ngrirë, sepse diplomacia, fatkeqësisht, mësohet dhe u përshtatet fakteve të kryera. A e përmend kush sot pas dhjetë vjetësh aneksimin rus të Gjeorgjisë, i cili mbeti konflikt i ngrirë, që nga gushti i vitit 2008? Apo tash e katër vjet konfliktin e ngrirë në Ukrainën Lindore. Fatkeqësisht, ky model i sprovuar i konfliktit të ngrirë po mbahet tash e dy dekada edhe me Mitrovicën e veriut, duke propaganduar ndërkombëtarisht Kosovën si shtet të fragmentuar, që dëmtoi jo pak pozitën e saj ndërkombëtare.

Andaj është nevoja për një politikë të jashtme pro-aktive dhe të përditësuar më zhvillimet e fundit gjeopolitike. Me sa kuptova, Ministria e Punëve të Jashtme vepron mbi bazën e më shumë dokumenteve qeveritare dhe ka nevojë për hartimin e një dokumenti strategjik unik. Kjo strategji e politikës së jashtme do të duhej të bazohej në tri themele, mbi të cilat do të ndiqeshin pastaj tri prioritetet kyçe.

Këto tri themele të strategjisë së politikës së jashtme do të ishin:

1. Interesi shtetëror
2. Aleancat ndërkombëtare dhe
3. Kompatibiliteti i tyre me orientimin euroatlantik.

Bazuar në këto tri themele, Ministria e Punëve të Jashtme do

ta ndiqte implementimin e tri prioriteteteve kyçe si:

o Shtimin e njohjeve ndërkombëtare, (së paku deri në 2/3 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së);

o Anëtarësimin e Republikës së Kosovës në OKB (dhe organizatat e tjera ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, OSBE, NATO dhe BE);

o Përmbyllja e dialogut Kosovë - Serbi me marrëveshje obliguese juridike për njohje reciproke ndërshtetërore.

Vetëkuptohet se në një prezantim të shkurtër si ky sot, nuk mund të operacionalizohen më tutje prioritetet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, që i mbetet Ministrisë së Jashtme, por në vijim vetëm do ta përmend thelbin e tyre.

Nuk zbuloj asgjë të re nëse them se mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës në kufijtë ekzistues, mbetet interes kyç shtetëror. Mbrojtja e këtij interesi si udhërrëfyes për politikën e jashtme të Kosovës duhet të jetë në korrelacion me aleancat strategjike, pra me komunitetin euroatlantik. Nëse synim strategjik i Kosovës tash e një shekull ishte çlirimi nga Serbia dhe shtetëzimi i saj; dhe nëse kjo u arrit falë mbështetjes së aleancës më të fuqishme ushtarako-politike në botë, cili do projekcion strategjik i politikës së jashtme të Kosovës

duhet ta respektojë kompatibilitetin e interesit shtetëror me interesat strategjike të aleatëve tanë perëndimorë.

Kombi shqiptar dhe shteti i Kosovës mbeten më pro amerikanët në Evropë me bazën më të madhe të NATO-s në Ballkan (Bonstill) dhe së shpejti me bazën e parë ajrore të NATO-s në rajon (Kuçovë). Tash duhet analizuar nëse edhe ShBA-ja në dekadën që vjen do të ketë në fokus Ballkanin dhe rrjedhimisht Kosovën?

Si shtet i ri dhe i vogël, Republika e Kosovës, nuk mund të ekzistojë pa aleatë të mëdhenj. Fundja shtetet e vogla kanë pozitë specifike në marrëdhëniet ndërkombëtare, por ca nga to duke qenë në udhëkryqin gjeostrategjik mund të kenë edhe peshë domethënëse në politikën e jashtme. Së paku këtë pozitë deri më sot e gëzonte Kosova si udhëkryq i dy korridoreve rrugore pan evropiane: 8 dhe 10, dhe afër dy korridoreve energjetike "Turkiah Steam" dhe TAP.

Vetëkuptohet edhe për Kosovën mbetet sfida e njëjtë si për të gjitha shtetet e vogla, si t'i ruajnë kufijtë, pra integritetin territorial dhe sovranitetin shtetëror?

Sidomos në situatën kur ajo: përbrenda ende nuk ka shtrirë sovranitetin e vet në çerekun e territorit, ndërsa jashtë ende nuk është anëtare e OKB-së

shkaku i vetos ruse në KS. Rezoluta 1244/99, ndonëse relik virtual jashtë realitetit aktual, mbeti pengesa e fundit për pengimin e anëtarësimin të Republikës së Kosovës në Kombet e Bashkuara.

Strategjia e politikës së jashtme të Kosovës, nëse nuk mund ta zhbëjë këtë rezolutë (shkaku i procedurës në KS), atëherë me aleatët e vet, së paku duhet ta relativizojë sa më shumë: siç bëri muaj më parë Britania e Madhe si kryesuese e KS të OKB-së, duke ndaluar diskutimin periodik për implementimin e saj, apo duke kërkuar tërheqjen e UNMIK-ut siç kërkon ShBA-ja kur e kritikoi atë si një "staf aq i madh, me përgjegjësi aq të vogël".

Më tutje, kjo strategji duhet ta fokusojë veprimin diplomatik jo vetëm te shtetet që e kanë njohur Kosovën (116 sish), por shumë më tepër tek ato që nuk janë shprehur kundër njohjes, si dhe tek ato që e kundërshtojnë njohjen e saj (rreth 60 sish). Në vend të përfundimit, një strategji e politikës së jashtme të Kosovës është imediate dhe konform saj, një plan veprimi me prioritetet të periodizuara për dekadën e dytë të Republikës së Kosovës.

(Ky fjalim është mbajtur në Konferencën e Pestë të Ambasadorëve në Prishtinë, 6 - 7 shtator. Fusnotat i ka hequr redaksia)

Haradinaj, kryetarëve të komunave: Të bëhemi bashkë për ta ndryshuar gjendjen mjedisore

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 7 SHTATOR - "Qeveria është partnere e të gjithë juve në procesin e nisur për një ambient sa më të pastër. Është e pamundur që aksioni për pastrimin e Kosovës të ketë sukses pa kontributin e të gjithë qytetarëve të Kosovës, kryetarëve të komunave, nivelit qendror dhe atij lokal, organizatave dhe të gjithë atyre që e duan një Kosovë të pastër", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në tryezën me kryetarë të komunave ku është diskutuar për zhvillimet dhe planet në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, organizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe GIZ-i.

Ndonëse e iniciuar nga Zyra e Kryeministrit, kryeministri Haradinaj ka thënë se aksioni për pastrim është temë e të gjithëve pa dallim. "Janë dy dekada që Kosova ballafaqohet me problemet mjedisore, me theks të veçantë me ndotje dhe papastërti të mjedisit në të cilin jetojmë. Është momenti i fundit që të gjithë të bëhemi bashkë dhe të reflektojmë për ta ndryshuar këtë gjendje", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se vetëm së bashku mund ta pastrojmë



Kosovën. Po ashtu, kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria do t'i bashkohet idesë për dhënie e grantit për komunat që tregojnë sukses në pastrimin dhe ruajtjen e ambientit.

Kryeministri Haradinaj ka deklaruar se sfida e ambientit të pastër zgjidhet me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të

Mbeturinave, duke theksuar se pas aksionit për pastrimin e Kosovës, që do të zgjasë tre muaj, do të fillojnë politikat ndëshkuese për ata që hedhin mbeturina dhe që nuk respektojnë normat ligjore.

Më tutje, Haradinaj i ka informuar të pranishmit se në aksionin për pastrimin e Kosovës janë ftuar të gjithë mekanizmat dhe është e

pamundur që ky aksion të jetë i suksesshëm pa kontributin e kryetarëve të komunave. "Ju siguroj që në fund, pas kësaj pune të mundimshme, të gjithë do të jemi fitues", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se çdo sinjal pozitiv në Kosovë e përmirëson disponimin e qeverive të BE-së karshi Kosovës, por edhe për

liberalizim të vizave. Në këtë tryezë folën edhe ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, udhëheqësja e sektorit të menaxhimit të mbeturinave në kuadër të GIZ-it, Alexandra Linden, derisa kryetarët e komunave shprehën gatishmërinë e tyre që të jenë pjesë e aksionit "Ta pastrojmë Kosovën".

Asfaltohen dy rrugë në fshatin Ngucat të Malishevës

MALISHEVË, 7 SHTATOR (ER) - Në fshatin Ngucat të Komunës së Malishevës është duke vazhduar asfaltimi i dy rrugëve të këtij fshati. Për këtë qëllim, asfaltimin e rrugëve e ka parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili është takuar edhe me banorët. "Edhe fshatrat e thella, edhe lagjet në këto fshatra janë pjesë e vendbanimeve të Komunës së Malishevës dhe ne si qeveri komunale jemi duke u munduar ta ndërtojmë infra-

strukturën, edhe në këto zona të thella, në mënyrë që të gjithë banorët të jetojnë në kushte të njëjta, pavarësisht prej largësisë që kanë nga qendra komunale", ka thënë Begaj.

Asfaltimi i 1 250 metrave rrugë në këtë pjesë është mundësuar nga buxheti Komunal i Malishevës që ka kushtuar rreth 70 mijë euro, ndërsa këto rrugë e lidhin këtë pjesë të fshatit me rrugët kryesore dhe në masë të madhe ua lehtëson jetesën banorëve.



Mitrovica do të jetë përfituese e granteve nga Ministria e Bujqësisë

MITROVICË, 7 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga drejtori i Bujqësisë, Ekrem Sadiku, kanë pritur në një takim pune zëvendësministrin e Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Shukri Maxhuni dhe këshilltaren politike të kësaj ministrie, Danica Laban.

Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi në lidhje me projektet në të cilat do të përfshihet Komuna e Mitrovicës gjatë vitit

të ardhshëm si dhe njohja me shqetësimet që kanë fermerët e kësaj komune. Fillimisht zëvendësministri Maxhuni ka njoftuar kryetarin Bahtiri se vitin e ardhshëm pritet të ketë grante nga Qeveria dhe se do të përipiqet që edhe Komuna e Mitrovicës të jetë përfituese në mënyrë që fermerët mitrovicas t'i realizojnë qëllimet e tyre. Po ashtu, Maxhuni e ka njoftuar Bahtirin dhe drejtorin Sadiku se kjo vizitë po realizohet në kuadër të vizitave që po bëjnë nëpër komuna për t'i identi-

fikuar nevojat e komunave në sektorin e bujqësisë dhe për projektet që ministria planifikon t'i realizojë, me qëllim të një zhvillimi të barabartë dhe të balancuar të komunave. Ndërsa kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka falënderuar zëvendësministrin Maxhuni për iniciativën që kjo komunë të jetë pjesë e këtyre projekteve, derisa ka thënë se vendi ynë është vend kryesisht rural, ku mund të zhvillohet blegtoria, pemëtaria dhe degë të tjera bujqësore.



Komuna e Prizrenit përkrah fermerët për ngritjen e 50 serave

PRIZREN, 7 SHTATOR (ER) - Pas përkrahjes së fermerëve me motokultivatorë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, fermerët e Komunës së Prizrenit janë përkrahur edhe me ngritjen e 50 serave. Vlera financiare e këtij projekti është rreth 162 mijë euro, ndërsa ngritja e serave është bërë në një sipërfaqe prej 15.600 m².

Kryetari i Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka thënë se fermerëve prizrenas do t'ia sigurojnë tregun për shitjen e prodhimeve të tyre. "Tradita e fermerëve tanë në prodhimtari bujqësorë në fusha të hapura, e bën edhe më të lehtë aftësimin e tyre për prodhimtari bujqësorë në sera. Neve na mbetet që këtyre punëtorëve të vyer t'ua siguro-

jmë tregun për shitjen e prodhimeve të tyre", ka thënë Haskuka.

Komuna e Prizrenit ka theksuar se përmirësimi i kushteve për zhvillimin e bujqësisë dhe aftësimi i fermerëve për prodhimtari intensive mbetet prioritet që prodhimet bujqësore të jenë konkurrense në tregun vendor dhe rajonal.

Muharremaj kërkon nga mirëmbajtësit e shkollave angazhim maksimal

THERANDË, 7 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës të Therandës, Bali Muharremaj, ka pritur në takim punëtorët teknikë të shkollave të kësaj komune. Gjatë këtij takimi Muharremaj ka kërkuar angazhim maksimal nga punëtorët teknikë të shkollave të kësaj komune për mbajtjen e pastërtisë në shkolla. "Nga punëtorët

teknikë (mirëmbajtësit) e shkollave jam njoftuar mbi kushtet e punës dhe sfidat e tyre. Kam kërkuar angazhim serioz nga ana e tyre për pastërtinë në shkolla dhe oborre. Shkollat duhet të kenë ambient të pastër dhe të përshtatshëm për t'u zhvilluar mësimi brenda kriterëve normale", ka deklaruar Muharremaj.



Bajram Hasani flet pas largimit nga posti i ministrit Tregtisë dhe Industrisë

Hasani: Jam zotuar se nuk bëj kompromis me të keqen

"Të jesh ministër i shtetit tënd është nder e privilegj, por jo në rrethana të tilla si në Kosovë. Ditën që i jam futur politikës dhe jam emëruar ministër e kam pasur të qartë se do të jetë një rrugëtim i vështirë. Atë ditë jam zotuar para familjes sime, para miqve dhe njerëzve të këtij vendi, se nuk do të bëj kompromis me të keqen", kështu ka deklaruar të premten Bajram Hasani pas largimit nga posti i ministrit të Tregtisë dhe Industrisë



Ai ka thënë se gjatë kohës sa ka drejtuar me MTI-në ka arritur t'u them stop të këqijave. "Shpresoj se gjatë kohës sa kam drejtuar me MTI-në kam arritur t'u them stop të këqijave, të kem arritur të rregulloj segmente të rëndësishme që prekin jetën e qytetarëve të Kosovës, që prodhuesve vendorë t'ua kem ofruar mbështetjen e duhur institucionale dhe rregullimin e infrastrukturës ligjore. E krejt punët e mira që kemi bërë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë gjatë këtij viti, nuk mund të mendoreshin pa punën profesionale dhe me përkushtim të të gjithë stafit të kësaj ministrie", ka thënë ish-ministri Hasani. Ai ka falënderuar të gjithë kolegët në MTI, drejtorët e departamenteve, kryeshefat, stafin e tij për punën e palodhshme. "Bashkë me njerëzit e zellshëm të MTI-së përgjatë një viti kemi bërë punë që nuk janë bërë për një kohë të gjatë. Andaj, u jam mirënjohës secilit veç e veç", ka thënë Hasani.

PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - Bajram Hasani, ish-ministër i Tregtisë dhe Industrisë, ka folur për herë të parë publikisht pasi është shkarkuar nga partia e tij të mërkurën. Nisma Socialdemokrate e Kosovës i ka kërkuar kryeministrit Ramush Haradinaj që ta lirojë nga detyra Bajram Hasani, që ka drejtuar Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë pa dhënë sqarime për arsyet. Ministri kishte qëndruar i heshtur për këto arsye, ndërsa të premten përmes një statusi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se është munduar të mos bëjë kompromis me të keqen. "E ndiej për obligim dhe

të nevojshme t'jua jap një sqarim pas ngjarjeve të fundit. Siç e dini, unë më nuk jam pjesë e Qeverisë së Kosovës, konkretisht Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Të jesh ministër i shtetit tënd është nder e privilegj, por jo në rrethana të tilla si në Kosovë. Ditën që i jam futur politikës dhe jam emëruar ministër e kam pasur të qartë se do të jetë një rrugëtim i vështirë. Atë ditë jam zotuar para familjes sime, para miqve dhe njerëzve të këtij vendi se nuk do të bëj kompromis me të keqen. E kam pranuar këtë detyrë për të punuar për të mirën e njerëzve të këtij vendi", ka thënë Hasani.

Dogana e Kosovës inkasoi 736.4 milionë euro

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Gjatë periudhës raportuese janar-gusht të hyrat e përgjithshme të inkasuar nga Dogana e Kosovës kanë arritur vlerën rreth 736.4 milionë euro që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017, paraqet një rritje prej 18 milionë eurosh apo 2.5 për qind me shumë se periudha e njëjtë e vitit paraprak. "Për më tepër, ndikimi në të hyrat nga pakot fiskale që i referohen lirimit në import të taksave për prodhues përgjatë periudhës raportuese është rreth 49.9 milionë euro, që paraqet një



rritje rreth 173 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Ndërsa sa iu përket lirimeve sipas MSA-së, duhet theksuar se ndikimi nega-

tiv në të hyra nga MSA-ja përgjatë kësaj periudhe është rreth 28.9 milionë euro apo rreth 44.52 për qind më shumë sesa periud-

ha e njëjtë e vitit të kaluar", është thënë në njoftimin e Doganës së Kosovës. Sipas këtij njoftimi, ndikim në të hyra ka pasur edhe kufizimi i importit të automjeteve të përdorura deri në dhjetë vjet, ku në këtë kategori tek importi i veturave vërehet rënie e theksuar e të hyrave krahasuar me vitin e kaluar. "Kemi 8 361 vetura më pak dhe kjo ka ndikuar të shënohet një rënie në të hyra tek kategoria e veturave rreth 12 milionë euro më pak se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Pavarësisht prej politikave fiskale që favorizojnë lirime dhe ulje taksash në kategori të caktuara, si stimulim i zhvillimit

ekonomik, si dhe ato që burojnë nga marrëveshja e Stabilizimit Asociimit, që këtë vit po kanë ndikim më shumë në të hyrat e planifikuara, përsëri Dogana e Kosovës është duke vazhduar me performancë shumë të mirë grumbullimin e të hyrave, luftimin e ekonomisë joformale, kontrabandës dhe fushave të tjera që Dogana ka përgjegjësi, mirëpo gjithashtu vlerësojmë se këto efekte të politikave fiskale dhe të MSA-së do ta kenë efektin e vet pozitiv shumë më të madh për zhvillimin ekonomik të vendit dhe rritjes së prodhimeve vendorë", është theksuar në njoftimin e Doganës.

Reçica ua dorëzon pensionistëve të dhënat zyrtare të viteve 1990-1998

PRISHTINË, 7 SHTATOR (ER) - Duke zbatuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, që i jep të drejtë Federatës së Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës, për qasje në të dhënat zyrtare të pensionistëve të Kosovës të pensionuar në periudhën 1990-1998, të premten ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale,

Skender Reçica, ka pritur në takim Shaban Kelmendin, përfaqësues i autorizuar i Federatës së Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës. Këtij të fundit ministri Reçica ia ka dorëzuar të dhënat zyrtare të mbi 80 000 pensionistëve të kësaj periudhe. Me këtë rast, Reçica ka thënë MPMS-ja është duke përbushur një

obligim ligjor dhe moral ndaj pensionistëve të Kosovës, duke theksuar se MPMS-ja mbetet e përkushtuar t'u dalë zot të gjithë pensionistëve në vend. Ndërsa Shaban Kelmendi ka falënderuar ministrin Reçica për pritjen dhe përkushtimin për ta realizuar kërkesën e Federatës së Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës.



Synetia e Hashim Thaçit përmes 'korrigjimit të kufijve' me Serbinë!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Larg syve, larg zemrës: Njeriu duhet të mësohet edhe me humbjen e atyre që i ka dashur dikur shumë dhe se nuk ka hidhërim të përjetshëm. Jeta vazhdon dhe kujtimet mbesin. Dashuri të përjetshme nuk ka, vetëm interesë është i përjetshëm. Më duhet ta pranoj se kohët e fundit po ndihem shumë i shqetësuar sepse "Shkëlqesia e Tij", presidenti i Republikës së Kosovës, zotëri Hashim Thaçi, më ka marginalizuar aq shumë sa që edhe gjumin ma ka çregulluar e mos të flasim për ëndrrat. Njeriu, pas humbjes së madhe, nëse arrinë t'i ruajë mendtë në kokë, e vlerëson nëse vazhdimi i jetës ka kuptim, në rrethana të reja apo... apo?! E sheh me kend të ka zëvendësuar ai që, tash të ka flakur nga jeta dhe kujtimi, motivi pse e ka bërë këtë dhe pasojat apo përfitimet për kombin apo shtetin. Dhe nëse del se e mira e përgjithshme identifikohet me të zgjedhurin e ri, jo se nuk keni arsye të bëheni nervoz apo t'u mbetet hatri, por se duhet të pranoni si përparësi, duke e shndërruar në ngushëllim. Publikisht po e them se kurrë nuk do t'ia falja Hashimit "tradhëtinë" duke më zëvendësuar me të tjerët, cilido qoftë ai kurse, në rastin konkret, pasi më zëvendësoi me Aleksandër Vuçiqin, falë i qofshin djathi i Shumadisë dhe përkthyesja e Daçiqit. E di unë sikur që e dini edhe ju, lexues të nderuar, se Hashimi këtë e ka bërë, kursesi për shkaqe personale, përfitime materiale apo motive të tjera por, pa asnjë dyshim, e ka bërë për kombin dhe shtetin. Për cilin komb e cilin shtet ende nuk e kam të qartë, e shohim më vonë! Çka mund t'i ofroj unë Hashimit krahasuar me Vuçiqin?! Asgjë dhe hiçgjë! Po e shihni sa dorëlibër është Vuçiqi, pa një pa dy po ia dhuron Hashimit Luginën e Preshevës përmes korrigjimit të kufijve. Edhe Hashimi është i zgjuar, shumë i zgjuar, jashtëzakonisht i zgjuar! Ka mundur t'ia marrë

Vuçiqit, kur të ketë dashur, Luginën e Preshevës dhe ta zhveshte Aca Ujkun nga çdo ndikim në Serbi, por e zgjodhi rrugën e duhur, edhe po e merr Luginën e Preshevës, edhe po e ruan Vuçiqin! Kjo është politikë dhe jo ajo që po e bëj unë që po llomotis për rrezikun e humbjes së territorit të Kosovës përmes "korrigjimit të kufijve". Kadria e ka vërejtur këtë injorancën tonë që po e hapim çështjen e kufijve prandaj me të drejtë po na quan se jemi serbë dhe rusë. Në këtë kontekst po del se serbi dhe rusi më i madh në Kosovë jam unë, madje më serb se Shesheli (ai është melez nacional) apo Putini (ai është rus origjinal). Deri më tani, përveç Hashimit, asnjëri në Kosovë kurrë nuk i ka përmedur kufijtë. Të gjithë kanë dalë në mbrojtje të kufijve dhe njëri më ka bërë shumë përshlyetje dhe që i besoj shumë, si mbrojtës i pakompromis i kufirit (cilit, nuk e kam ende të qartë) është Begja, Pacolli, që nuk la vend të botës pa shkelur në mbrojtje të intereseve personale dhe biznesit që e ka, dikush po thotë (unë nuk e them) së bashku me Hashimin. Shteti i Kosovës i përkrahë, me të gjitha mundësitë që i ka, por edhe që nuk i ka, qytetarët e saj që janë ambiciozë dhe që e përfaqësojnë Kosovën në mbarë botën qoftë edhe për qëllime personale, prandaj Behgjetit të Pacollëve ia ka ndarë një rrogë modeste prej disa mijëra eurosh, i ka siguruar mbështetje logjistike dhe nuk i ka vënë vija ku mund të shkojë dhe ku nuk mund të shkojë, ia mbulon të gjitha faturat, e ka kartelën grithëse bankare me të cilën gjithmonë fiton sikur që ka mundësi të pijë shvepsa, sa të dojë dhe kur të dojë. Kur është puna të shvepsi, gjithmonë më kujtohet halla Mihri që kur vinte mysafire te ne gjithmonë kërkonte të pijë ç(sh)veps. Merreni me mend të jetonte vetëm edhe pak dhe të takohej me Pacollin, shvepsi do të rridhte ujë.

E dëgjova mbrëmë një intervistë të Blendit (partneri i Batonit) me Hashimin, me shumë kujdes dhe me kapacitetin intelektual, profesional dhe politik që e kam dhe e pranoj se në këtë drejtim jam shumë leshko (inJORANT fare) dhe mbeta pa mend! Nuk është humbje e madhe mungesa e mendve, te ne është përparësi

sidomos nëse mendon të ndërtoj një karrierë politike apo intelektuale. Aq ishte i bindur Hashimi se e ka në dorë Luginën e Preshevës dhe gati e rrahu Blendin kur kërkonte fakte shtesë që e mbështet këtë siguri sa që mbeti vetëm të caktohej data dhe dita kur do të prehej shiriti i inagurimit të bashkimit të Luginës së Preshevës me Kosovën. Më çuditë që Hashimi nuk e bëri publik faktin se për prefekt të Preshevës e ka emëruar Valon Muratin, të Bujanovcit Avni Klinakun dhe të Medvegjës Gani Jasharin. Nuk ka kuptim që territorin mos ta mbulon me liderë të duhur. Edhe në një intervistë që Kadria e pati te Batoni (Batoni është i hapur për të gjithë e sidomos për tereqtë e politikës), kur ai i foli diçka për Mitrovicën, Kadria gati sa nuk e nokautoi. Edhe ashtu Batoni, i shtrembëruar si Kulla e Pizës në Itali (nuk e di nëse e ka shkak i boshtit kurrizor apo për shkak të ushtrimeve për ta mbajtur trupin fit) ishte thuaja i shtrirë. Mjaftonte, jo një grusht i Kadrisë, por lëshim ajri i intensitetit të ulët dhe të pa zë e që Batoni të shtrihet si Bar Rafaeli para Leonardo di Kaprios. Po të isha në vend të Kadrisë, atë intervistë te Batoni do ta shlyeja nga të gjitha arkivat dhe aspak nuk më habitë një këshilltar i Kadrisë kur tha se kjo ishte intervista më e mirë e të gjitha kohëve e Kadrisë. Jeta dhe ngjarjet më kanë disiplinuar që të mos reagoj ashtu siç e meriton naj kastravec, i veshur me rroba të këshilltarit politik, plus edhe i kollarisur! Në atë intervistë Kadria më ka prekur shumë duke ma ngatërruar të kaluarën time kombëtare dhe patriotike, Hashimi do t'i korrigjojë kufijtë, mua më konsiderojnë serb dhe rus. Mua, që e kam prejardhjen nga Shala e Bajgorës, përkatësisht nga fshati Kovaçiqë, trashëgimi fisnore (por jo edhe nga trimëria) e Ukshin Kovaçicës, nga ana e babait, kurse stërnip i Cen Maxhunit dhe menxhiqëve, nga ana e nënës. Thuhet se nga beteri del Skenderi, kurse nga Skenderi del beteri. Në rastin konkret, prejardhjen e kam nga dy skenderë dhe asnjëri beteri dhe fort m'u ka prekur sed(t)ra patriotike. Plus, jam rritur në një oborr me Rada Trajkoviçin që po del të jetë më patriote se shumë politikanë kosovarë,

këngën: "Druzhe Tito, mi ti se kunemo e kam ditur përmendsh". E kam dëgjuar me pasion këngën patriotike: "Fadil Hoxha në kali të bardhë...". E pata shkruar një ese ekselent për patriotët e mëdhenj Ali Shukria, Sinan Hasani, Kol Shiroka etj. Pata bashkëpunuar ngushtë me ish të burgosurin politik Azem Vllasin. I kam lexuar të gjitha veprat e Vetonit. Dhe shumë të tjera që për shkak se jam prekur nga arterioskleroza dhe harresa, e që do ta mbushnin kornizën time puro patriotike, nuk po jem në gjendje t'i shkruaj. Pas të gjitha këtyre fakteve e shkruar fakteve, të dyshojë dikush në patriotizmin tim, është mëkat, është blasfemi. Edhe në kohën kur nuk ma mori Aca Hashimin, Hashimi disi më pati futur në mesin e atyre që kanë deficit patriotik (nuk kam dëgjuar asgjë më gjëniale deri sot) e tash Kadria po më bën kushëri me Vulinin dhe Çernomirdinin. Më në fund edhe Hashimi e mori hundëve, Aca as që ia vari në Bruksel. Mbeti Hashimi, pa dy, një ish-mik dhe një mik të sotëm, pa Begjën dhe pa Acën. Njëri më tha, as që brengoset për juve, ty (Bexhën) e zëvendëson me Begjën (Pacollin), kurse Acën e zëvendëson me Baton! Ka logjikë këtu, shumë logjikë! Diplomacia e sulmuar, shtetësia e dhunuar: Të jem i drejtë, i tillë do të duhej të jem, që nga koha e Haxhi Kudrës, Kosova kurrë nuk ka pasur diplomat më të zotin se Behgjet Pacollin. Disa informata për personalitetin e Haxhi Kudrës në mënyrë që lexuesit ta kenë më të qartë krahasimin dhe rolin e këtyre dy personalitetëve shqiptarë dhe kosovarë në misionin diplomatik në të kaluarën dhe sot. Haxhi Haxhiu, me nofkën përkëdhelëse Haxhi Kudra, ka qenë diplomat i shekullit të kaluar e që nuk ka lënë vend pa shkelur në ish-Jugosllavi dhe ish-Serbi, duke filluar nga stacionet policore, komitete komunale, krahinore, republikane dhe federative, pa shkuar dhe pa dërguar informatat e nevojshme për shqiptarët që jo se flisnin, por edhe pse ëndërronin kundër Jugosllavisë dhe Serbisë. Sipas emrit, del të jetë i gjinisë mashkullorë dhe mund të quhej Haxhi Qeni, por filozofia e popullit është mbi filozofinë e Kantit, Hegelit, Platonit dhe të

tjerëve, prandaj e quajtën Haxhi Kudra. Kudra është më besnik se qeni, prandaj Haxhia, si besnik i Serbisë dhe Jugosllavisë, e meriton këtë mbiemër. Ua luante bishtin të gjithëve, prandaj edhe quhej Haxhi Kudra. Kur pas një raportimi në UDB-në në Nish, piu shlivovicë më shumë, policët i aplaudonin pasi e luante vallen serbe me fjalët: "Igraj (vallëzo) kudro". Shqiptarët e Llapit, porsa e shihnin, thoshin: "Mos folni, se erdh Haxhi Kudra". Kurrë nuk e dërgonte vetëm një informatë te UDB-a serbe, por i pille shumë informata sikur që e bënë këtë Kudra që pjellë shumë këlyshë. Haxhi Kudra i përket së kaluarës.

Sot diplomacia e Kosovës e ka njeriun e duhur, në vend të duhur, Begjet Pacollin. Nuk ka lënë vend pa shkelur në botë, Amerikë, Afrikë, Azi, Evropë, Oqeani e ku jo. Vetëm për Kosovën dhe çështjen e Kosovës. Nuk ka mbetur vend pa e njohur Kosovën! Jo për shkak të Behgjet Pacollit, por për shkak të b.thëve të Rita Orës. Më shumë kanë prodhuar njohje për Kosovën dhe rreth Kosovës sutjenët e Rita Orës dhe brektë e Dua Lipës se Behgjet Pacolli me krejt stafin diplomatik, ambasadorë dhe ambasadore, konsuj dhe sekretarë etj. Kjo ishte në të kaluarën, deri para një muaji, kur situata në fushën diplomatike ndryshoi rrënjësisht dhe në të mirë të Pacollit. Kjo ndodhi me emërimin e dy ambasadorëve me përvojë të gjatë diplomatike dhe suksese të jashtëzakonshme në të gjitha sferat ku nuk kanë punuar dhe ku nuk kanë vepruar. Ata janë: Gjergj Dedaj, një ekzemplar i hiçit dhe jovlerës dhe Avni Kastrati, i kastruar nga çdo sukses, kudo që u angazhua në politikë! Kjo është diplomacia e Kosovës ose, ta parafrzoj një thënie të jugonostalgjikëve: "Edhe pas Titos - Tito", "Edhe pas Haxhi Kudrës, Haxhi Kudra"!

Protestat kundër Gjarprit: U mbajtën për herë të tretë protestat që kërkonin rrëzimin e Lekë Lumezit, Vetingun për gjyqësorin e Kosovës, pastrimin e listave për veteranët e Bllacës dhe këto kërkesa u fisnikëruan me kërkesën kundër Hashim Gjarprit dhe modelimit të kufijve të Kosovës. Këto protesta, sipas meje, me këtë format, me këtë përbërje dhe të caktuara të

mbahen një herë në javë, nuk mund të jenë të suksesshme. Numri i protestuesve është larg masës kritike kërcënuese e të nevojshme për arritje të qëllimit. Ata që po marrin pjesë në protestë janë recidivistë thuaja të të gjitha protestave e që nuk kanë dhënë asnjë rezultat. Krerët e protestës, përjashtuar disa raste, nuk janë aspak më të uritur për pushtet se këta që janë në pushtet. Nuk është e ndershme të kërkon Veting për një kategori kur në mesin e protestuesve keni milionerë që kanë bërë miliona me ndihmën e atyre që tani duan t'i rrëzojnë. As në treg me shumicë, e sidomos me pakicë, kurrë lëkura e qenit nuk ka qenë më e vlefshme se lëkura e gjarprit. Për ta zhveshur gjarprin nga lëkura (pushteti) duhet të ketë protesta të përditshme me së paku 50 000 protestues. Këta që po i bëjnë këto protesta nuk mund ta bëjnë këtë prandaj, më së shumti që mund të fitojnë do të jetë lëkura e qenit. Gjarpri do të

mbetet pa lëkurë vetëm në fund të procesit ku detyrohet ta luajë vallen e gjarprit. Partitë politike nuk mund të merren vesh si do ta ndajnë pushtetin në rast se me protesta e marrin pushtetin e që gjasat janë të vogla. Isa ose të dhjetë (10) së paku kryetarët e LDK-së, nuk ia japin postin e kryeministrit Albinit, kurse Albini kurrë nuk do të pranojë post tjetër. Tash e kanë edhe një kandidat shumë serioz për postin e kryeministrit, udhëheqësin e protestës Lumez ik! Ai është analisti shembullor, vizionari legjendar dhe sakrifikuesi i makiatos, Imer Mushkolaj.

Ekipi negociator: Deri më tani kishim një ekip negociator, Hashim Thaçin me çetën e patericave. Hashimi fliste dhe vazhdon të flasë në emër të tyre, ata e kanë për detyrë t'i lëprijnë fjalët dhe jo vetëm fjalët e Hashimit për një grusht eurosh, për një verë Chianti, për një pjatë kallamari dhe për 4-5 lugë pastë kallakari. Kur Hashimit i

erdhi veza te dalja emergjente, e formoi një ekip negociator të qeverisë, të hurit dhe të konopit. Pozita, në mungesë të sensit politik, e pengoi votimin e këtij grupi negociator, në vend se ta përkrahin dhe ta nënshkruajnë Rezolutën e propozuar nga opozita. Çka ka të keqe dhe të dëmshme nëse e nënshkruani Rezolutën që nuk lejon bisedime për kufijtë dhe tokën e Kosovës pavarësisht kush është në krye të këtyre bisedimeve. Qoftë ai të jetë edhe Hashim Thaçi apo Behgjet Pacolli, figura të ndritshme të popullit shqiptar! Votimin për ekipin negociator në Kuvend nuk e ka dëshiruar Hashimi sepse ka dashur të shkojë vetëm në takim me Vuçiqin. Një lojë e pistë po luhet në këtë mes. As opozita nuk është ajo që e mbron Kosovën. Po të ishin të tillë do të bashkëpunonin me pozitën duke e dërguar Listën Serbe në pension. Kështu, edhe pozita, edhe opozita është e varur nga Lista Serbe e Vuçiqit. Ky është

mjerimi i Kosovës. Ekipi negociator, i propozuar nga qeveria, është ekip i hurit dhe konopit. Fatmir Limaj po llogaritet si kundërshtar i Hashimit, por kur nuk do të propozohet në këtë post pa pëlqimin e Hashimit. Nëse Fatmiri do të luftojë me parime kundër Thaçit, pa dëshirën e Thaçit, do të mbetet pa koçë. Enver Hoxhaj, çka kërkon ky njeri në këto bisedime dhe kush i beson kur asnjëherë nuk i kanë besuar. Kjo vegjetë politike me afat të skaduar dhe pjesë e të gjitha gjellëve të ziera në dhe për Kosovën nga të cilat edhe sot po na shkon barku. Kënd e përfaqëson Dardan Gashi dhe kush po luan koçë me qytetarët e Kosovës duke ricikluar hiçgjë për gjithçka! Begjet Pacolli, fort ia ndien për Kosovën për t'u caktuar pjesë e Ekipit Negociator. Gjëja e fundit për të cilën i bie ndër mend Behgjet Pacollit është Kosova. Kjo është tragjedia e Kosovës dhe mallkimi për qytetarët e saj që ata që kanë punuar kundër

Kosovës, sot duan të vendosin për fatin e saj. Mahir Jaghillari. Edhe i dehuri 99.99 % nuk do ta propozonte për anëtar të Ekipit Negociator. Avni Arifi në këtë mes është si dele në mesin e ujqve. Pa dyshim se do ta shqyejnë disa hiena të këtij Ekipi Negociator sikur që e kanë shqyer Kosovën më parë, që nga Rankoviçi, kriminel Tito e deri te "humanisti" Millosheviq, baba politik i Aleksandar Vuçiqit. Të papërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm jeni. E keni gjuhën, kulturën, besimin, i keni varret, i keni dëshmorët, i keni martirët, e keni gjakun e derdhur, i keni të zhdukurit, të dhunuarat, e keni historinë. Ata dhe vetëm ata flasin për Kosovën, ata kanë mandat. Ju nuk keni mandat të flisni kundër tyre. Në ekipin negociator ka të tillë që e bënë luftën, por ka edhe të tillë që e luftuan luftën. Mbrojeni atë që e keni, mos kërkonin atë që nuk mund ta keni! Kaq!



Ministri Gashi inspektoi punimet në kullën e Fazli Boqollit në Raushiq

PEJË, 7 SHTATOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar kullën e familjes së Fazli Boqollit në Raushiq. Gjatë kësaj vizite ministri Gashi ka parë nga afër punimet që po bëhen në këtë kullë, investim i MKRS-së. Ministri Gashi u shpreh i kënaqur me punimet që janë duke u real-

izuar në këtë kullë. "Si ministri kemi ndarë mjete të mjaftueshme sipas kërkesës së Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në Pejë, me qëllim që këtë kullë, por edhe kullat e tjera në rrafshin e Dukagjinit t'i restaurojmë, sepse këto kulla kanë domethënie jashtëzakonisht të madhe dhe

historike të periudhave të ndryshme. Ne jemi të përkushtuar t'i ruajmë dhe t'i rikthejmë këto kulla në funksion, varësisht prej rolit që kanë pasur në të kaluarën dhe tani dhe besoj se edhe viti 2019 do të jetë vit i veçantë sa iu përket investimeve në këto kulla", ka thënë ministri Gashi. Ndërkaq drejtoresha për Trashëgimi

Kulturore në Pejë, Shpresa Gjonbalaj, ka falënderuar ministrin për mbështetjen dhe angazhimin që ka shprehur për t'i parë nga afër punimet e restaurimit të kullës së Fazli Boqollit. Kryefamiljari Fazli Boqolli ka falënderuar ministrin Gashi për kontributin dhe angazhimin që ka treguar për restaurimin e kësaj

kulle me vlera historike, po ashtu ka shprehur falënderim për të gjithë ata të cilët janë angazhuar rreth këtij restaurimi. Kulla përmban karakteristikat e objekteve fortifikuese familjare, e që janë tipike edhe për ndërtimin e tipit të njëjtë në Rrafshin e Dukagjinit. Si ndërtim u realizua në gjysmën e dytë të shek. XVIII.

Liderët e Ruisë, Turqisë e Iranit diskutojnë për Idlibin

TEHERAN, 7 SHTATOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, ka paralajmëruar Rusinë dhe Iranin se një sulm i forcave qeveritare të Sirisë dhe aleatëve të saj në provincën Idlib do të rezultonte me "masakër".

Erdogani ka folur në Teheran në një samit të zhvilluar mes presidentit iranian, Hassan Rohani dhe presidentit rus, Vladimir Putin, të cilët kanë thënë se Qeveria siriane "ka të drejtë" të fitojë kontrollin e gjithë shtetit, duke përfshirë Idlibin.

Të tre liderët janë takuar për të diskutuar situatën në veriperëndim të provincës siriane, në kohën kur po pritet që një ofensivë qeveritare mund të

rezultojë me numër të madh të viktimave dhe katastrofë humanitare. "Secili sulm i nisur apo që do të nisë në Idlib do të rezultojë me katastrofë, masakër dhe tragjedi të madhe humanitare", është cituar të ketë thënë Erdogani, i cili ka bërë thirrje për armëpushim.

"Ne nuk duam asnjëherë që Idlibi të kthehet në zonë të përgjakur".

"Nëse njoftojmë për armëpushim sot, unë besoj se do të jetë një nga hapat më të mëdhenj të këtij samiti" është shprehur ai.

"Kjo do të qetësonte civilët. Mendoj se një njoftim i tillë do të jetë fitore për samitin", ka thënë

Erdogani.

Ndërsa presidenti iranian, Hassan Rohani, ka thënë se luftimet në Siri do të vazhdojnë derisa të gjithë ekstremistët të largohen, sidomos nga Idlibi, mirëpo sipas tij në betejë nuk duhet të dëmtohen civilët.

Në anën tjetër, presidenti i Ruisë, Vladimir Putin, ka thënë se Qeveria e presidentit sirian, Bashar al-Assad "ka të drejtë të fitojë kontrollin e gjithë territorit kombëtar". Ai ka kundërshtuar thirrjet e Erdoganit për armëpushim, duke thënë se rebelët nuk kanë qenë pjesë e bisedimeve andaj armëpushimi nuk mund të bëhet në emër të tyre.

Vëzhguesi Sirian për të Drejtat e



Njeriut me seli në Britani, ka thënë se sulmet ajrore kanë goditur një pjesë të Provincës më 7 shtator, po të njëjtën ditë kur të tre liderët janë mbledhur për të diskutuar situatën në këtë pjesë.

Në këtë provincë gjenden dhjetëra mijëra rebelë, e cila kufizohet me Turqinë. Në mesin e këtyre rebelëve rreth, 10.000 prej tyre konsiderohet të jenë të lidhur me Al-Kaidën.

Zyrtarët dënojnë sulmin anonim nga brenda Shtëpisë së Bardhë

Zyrtarët kryesorë brenda administratës Trump, nga zëvendëspresidenti Mike Pence e deri te disa anëtarë të rëndësishëm të kabinetit, mohojnë se kanë autorizuar publikimin e opinionit në fjalë, i cili është bërë shkak për një debat të furishëm në Uashington lidhur me presidencën Trump

UASHINGTON, 7 SHTATOR - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tha se kushdo që qëndron pas autorit anonim të një shkrimi në gazetën "New York Times" që kritikon stilin e tij të udhëheqjes si "meskin dhe jofektiv" përbën një kërcënim për demokracinë. Duke folur në një tubim në shtetin e Montana të enjten mbrëmë, presidenti Trump sugjeroi që gazetarët e "New York Times"-it të gjejnë se kush në administratën e tij flet keq për presidencën e tij. Zyrtarët kryesorë brenda administratës Trump, nga zëvendëspresidenti Mike Pence e deri te disa anëtarë të rëndësishëm të kabinetit, mohojnë se kanë autorizuar publikimin e opinionit në fjalë, i cili është bërë shkak për një debat të furishëm në Uashington lidhur me presidencën Trump. "Operativë të pazgjedhur të shtetit brenda shtetit që kanë agjendat e tyre sekrete janë vërtet kërcënim për demokracinë", tha presidenti Trump në tubimin e Montanës. Ai tha se opinioni i botuar në "New York Times" shërbeu si bumerang duke e shtuar

mbështetjen për të.

Në Florida, nënpresidenti Mike Pence denoncoi anonimën e "New York Times"-it që e karakterizon presidentin Trump si "amoral". "Kushdo që do të shkruante një shkrim anonim që hedh baltë mbi presidentin, i cili i ka dhënë këtij vendi një rol të jashtëzakonshëm udhëheqës, nuk duhet të punojë për këtë administratë, por duhet të bëjë atë që është e ndershme dhe të japë dorëheqjen", tha ai.

Nënpresidenti Pence, Sekretari i Shtetit Mike Pompeo dhe anëtarë të tjerë të kabinetit ndërmorën gjithashtu hapin e pazakontë, duke dhënë deklarata ku mohojnë se janë autorët e shkrimit, autori anonim i të cilit thotë se është zyrtar i lartë në administratën Trump. Autori anonim deklaroi se ishte pjesë e një "rezistencë të heshtur" brenda administratës Trump që synon të frenojë disa pjesë të agjendës së presidentit dhe prirjet e tij më të këqija.

Presidenti e shprehu zemërimin e tij në Twitter dhe në Shtëpinë e Bardhë. "Askush nuk ka bërë ndonjëherë, në më pak se dy vjet,



atë që kemi bërë ne. Pra, kur flitet për një burim anonim brenda administratës, nuk jemi ne që po dështojmë. Është "New York Times" që po dështon", tha presidenti.

Shumë demokratë shprehën pikëpamje të ndryshme, si senatori Ed Markey i shtetit Massachusetts. "Pjesa alarmante që ka të bëjë me shkrimin është se dikush në Shtëpinë e Bardhë ka frikë se vendi ynë po dëmtohet çdo ditë dhe mendoj se këtë duhet ta marrim shumë seriozisht", tha Markey.

Republikanët në përgjithësi po shtrëngojnë radhët rreth presidentit, duke përfshirë edhe kryetarin e Dhomës së

Përfaqësuesve, Paul Ryan. "Është një person që natyrisht po jeton me pandershmëri. Kjo nuk e ndihmon presidentin", tha Ryan. Ndikimi i përgjithshëm politik mund të jetë minimal për presidentin, thotë analisti John Fortier. "Nuk mendoj se kjo do të ndryshojë mendimin e njerëzve për Donald Trumpin. Ata ose e pëlqejnë ose nuk e pëlqejnë atë; ata e kuptojnë thelbin e gjithë kësaj historie", tha ai.

Por të tjerët e shohin këtë ngjarje të fundit si më alarmante, duke përfshirë analistin demokrat, Jim Kessler. "Ka shumë njerëz në administratën Trump, brenda Shtëpisë së Bardhë dhe brenda rrethit të tij të brendshëm, që

thjesht nuk e pëlqejnë atë dhe nuk i besojnë atij dhe mendojnë se ai nuk është i aftë të jetë president", tha Kessler.

Përkrahësit e Trumpit ka të ngjarë ta shohin ndryshe çështjen, thotë Fortier. "Do t'i kundërvija kësaj sondazhet e opinionit që tregojnë se votuesi mesatar republikan është në thelb me Donald Trumpin. Ai nuk është president popullor, por gëzon mbështetje brenda bazës republikane", tha ai.

Polemikat e ditëve të fundit janë gjithashtu dëshmi e mëtejshme se presidenti Trump do të jetë tema kryesore në zgjedhjet e mesmandatit për Kongresin në nëntor.

ShBA-ja uron Maqedoninë për 27-vjetorin e pavarësisë

UASHINGTON, 7 SHTATOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, uroi të premten Maqedoninë për 27-vjetorin e pavarësisë dhe e siguroi për mbështetjen amerikane në hapat e saj për t'u bërë pjesë e "familjes euro-at-

lantike".

Pompeo e bëri urimin në emër të Shteteve të Bashkuara në prag të ditës së pavarësisë që Maqedonia e shënon më 8 shtator. "Ju urojmë për Marrëveshjen Historike të Prespës, e cila kur të zbatohet do

të sjellë më shumë siguri dhe mirëqenie për popullin e Maqedonisë dhe gjithë rajonin", thuhet në deklaratën e tij.

Sekretari amerikan i Shtetit vlerësoi angazhimin e vendit ndaj parimeve demokratike, shtetit

ligjor, përgjegjësisë së qeverisë dhe përpjekjet kundër korrupsionit.

Pompeo tha se Shtetet e Bashkuara shpresojnë në thellimin e miqësisë dhe partneritetit me Maqedoninë në të ardhmen.



Princeshë Diana dhe Nënë Tereza, historia e një miqësie të bukur



Një miqësi e bukur lulëzoi mes princeshës angleze dhe murgeshës katolike të moshuar që në takimin e tyre të parë. Ato u takuan për herë të parë më shkurt të vitit 1992 kur Diana fluturoi drejt Romës për të takuar një misionar 82-vjeçar, i cili kishte qenë i sëmurë për tu takuar në Kalkutë ashtu siç e kishin planifikuar.

Diana kishte tentuar dhe më parë për ta takuar Nënë Terezën, gjatë një udhëtimi që kishte pasur në Indi e shoqëruar nga Princ Charli më 1992. Princesha, një mbështetëse e organizatave bamirëse kishte udhëtuar në Kalkutë për të vizituar shtëpinë e saj në një man-

astir, por Nënë Tereza kishte qenë e sëmurë dhe nuk kishte mundur ta shihte. Pavarësisht kësaj Diana shkoi për vizitë në Manastir dhe më vonë do ta përshkruante këtë vizitë si një zgjim shpirtëror.

Ish-shërbëtori i saj Paul Burrell, tregon se ajo e përjetoj atë si diçka të thellë që kishte prekur në jetën e saj, veçanërisht kur motrat e manastirit i këndonin asaj, duke e bërë të jetonte një përvojë të jashtëzakonshme shpirtërore.

Takimi i parë – Princesha e takoi Nënë Terezën në Manastirin e Misionit të Bamirësisë në një lagje të vjetër të qytetit. Megjithëse Nënë

Tereza ishte duke u kujdesur për të varfrit ajo ishte e hapur ndaj çdo takimi, për tu shoqëruar me këndo që “Perëndia e Plotfuqishme” e sillte në rrugën e saj. Ajo dhe Diana u bënë menjëherë miqesha të mira pavarësisht stilit të tyre të kundërt. Sipas Butler Burrell princesha zbuloi një spiritualitet të thellë kur takoi Nënë Terezën ndërsa misionarja e përshkroi Dianën si shumë të shqetësuar për të varfrit, duke dashur të gjente forma për ti ndihmuar ata. Sipas Nënë Terezës kjo ishte arsyeja pse Diana ishte shumë pranë saj. Gjatë pesë viteve të ardhshme Diana dhe Nënë Tereza do të

takoheshin disa herë duke diskutuar shumë tema që kishin të bënin me bamirësinë por dhe me dy djemtë e saj Princin Harry dhe Princin Uilliam. Princesha ishte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të marrë pjesë në një ankand bamirësie të veshjeve të saj dhe të ardhurat i çoi për të ndihmuar njerëzit në vështirësi në Amerikë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Gjatë këtij udhëtimi ajo ndaloi për të takuar Nënë Terezën, e cila në atë kohë ishte në Bronks.

Princeshë Diana gjithmonë e mbështeti punën e Misionarëve të Bamirësisë dhe u raportua se pas takimit me Nënë Terezën,

ajo u ofroi atyre një shtëpi në Uashington DC për gratë shtatzëna të pamartuara që nuk kishin ku të shkonin. Dhurata tregoi mëshirën e vërtetë që Princesha Diana kishte për të varfrit. Nënë Tereza, e cila u kanonizua pas vdekjes në vitin 2016 dhe u bë një shenjtoje, e përshkroi natyrën e dashur të princeshës si “të bukur”. Nënë Tereza arriti të shihte shpirtin e bukur të princeshës së Uellsit dhe dëshirën e saj për të kontribuar për të varfrit. Nënë Tereza mbylli sytë vetëm pesë ditë më vonë pas vdekjes së parakohshme të Princeshës Diana në një aksident automobilistik. (*gazeta-Shqip.com*)

E rrallë

Turqi, në varrezat e lashta gjendet një shishe me krem



Arkeologët turq kanë gjetur një shishe me krem për sy gjatë eksplorimeve në varrezat e vjetra 2 200-vjeçare në qytetin e vjetër

Aizanoi. Ky qytet ndodhet në zonën e provincës perëndimore Kutahya, ndërsa që nga viti 2010 është në listën paraprake

të trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Shishja e gjetur është ekspozuar në muzeun arkeologjik në Kutahya.

BARSOLETA E DITËS



Mësuesja, duke i përfunduar notat, e pyet Agimin sa bëjnë 2+2?
Agimi i përgjigjet: Katër bëjnë, mësuese.
Mësuesja: Ulu, Agim! Pesëshe!
Agimi: E dita që bëjnë pesë, por u habita.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

“INCREDIBLES 2” 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird



FOTO E DITES



Drita e një treni shihet pranë lumit Sacramento në Kaliforni /AFP/

E jashtëzakonshme

Festivali i çuditshëm, pjesëmarrësit vendosin akrepa në kokë

Një festival i çuditshëm zhvillohet në Karnataka të Indisë, ku pjesëmarrësit duhet të luten dhe të vendosin akrepa në fytyrë dhe trup. Rituali zhvillohet si pjesë e një organizimi të religjionit Hindu, para se të gjithë të shkojnë në një tempull në kodër. Pjesë e ceremonisë me këto gjallesa të rrezikshme bëhen edhe fëmijët e vegjël, me besimin se mund t'ju sjellë bekim dhe shëndet.



Në ora 18:20

“FUTURE WORLD”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco

Në ora 20:00

“ANT-MAN AND THE WASP” 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed



Në ora 22:00

“LOVING PABLO” (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 min

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

 <p>DASHI Kreativiteti në maksimum sot sepse arti është kryefjala juaj. Nëse me fjalë nuk jeni shumë të shkathët, në ambient artistik ndiheni shumë rahat.</p>	 <p>DEMI Sot do t'i ankoheni një miku të mirë për të gjitha problemet që keni. Është gjithmonë një shpatull e mirë për t'u mbështetur në momente delikate.</p>	 <p>BINJAKËT Ndiheni mjaft konfuzë sot ndërmjet çështjeve të zemrës dhe përgjegjësive të reja profesionale. Do të donit të ishit diku tjetër.</p>	 <p>GAFORRJA Një miqësi e mirë këto muaj rrezikon të kthehet në një pasion të papërmbyshëm. Nëse doni të provoni, keni të gjitha shanset.</p>	 <p>LUANI Sot krenaria juaj do të marrë një goditje, sepse do të dëgjoni batuta aspak të këndshme kundrejt jush. Mos kënaqni ata që s'ju duan duke reaguar.</p>	 <p>VIRGJERESHA Edhe pse ndjeni konkurrencë, nuk do të shpërqendroheni në një projekt të sapunisura. Do të dini të merrni pozicionin që doni.</p>
 <p>PESHORJA Sot ndiheni më mirë me kënaqësitë shpirtërore se me ato financiare. Do të keni një surprizë gjatë gjysmës së dytë të ditës.</p>	 <p>AKREPI Xhelozia do të jetë instiktive sot për ju. Partneri do të ketë shumë problem për t'ju shpjeguar dhe justifikuar çdo gjest të ditës.</p>	 <p>SHIGJETARI Dita nuk do të jetë ajo që prisnit sot, por ju nuk do të bini në qetësi. Humori do t'ju karakterizojë përgjatë gjithë ditës.</p>	 <p>BRICJAPI Sot do t'i dedikoheni totalisht personit të zemrës. Të gjithë ju që keni bërë fjalë ose keni pasur probleme në çift, sot do t'i zgjidhni.</p>	 <p>UJORI Po ndiheni si të zënë në kurth sot sepse nuk po ju lejojnë të shprehni lirinë tuaj në mendime. Do të reagoni ashpër për të kërkuar te drejtën tuaj.</p>	 <p>PESHQIT Jeni të mirë dhe të ndjeshëm me kë është pranë jush sot, por surprizë do të kenë ata persona të cilët do t'ju bezdisin. Do të shohin anën tuaj më të keqe.</p>


Kështu e festoi Beyonce ditëlindjen



Beyonce e kishte ditëlindjen para tri ditësh, me ç'rast kishte marrë urime nga fansa anembanë botës. Ndërsa tani pasi kanë kaluar pak ditë, ajo vendosi të bëjë një postim, me një përmbledhje të shkurtër të jetës së saj personale. "Në moshën 36-vjeçare u bëra nënë e tre fëmijëve. I ushqeva binjakët me gj. I kam përditësuar betimet e mia me

bashkëshortin tim prej dhjetë vjetësh. U riktheva në shtëpi, në skenën e festivalit Coachella, pas shtatzënisë. Më pas unë dhe bashkëshorti im publikuam albumin tonë së bashku, Everything Is Love. Dhe kemi shëtitur me familjen tonë rreth botës dhe na ka pëlqyer. Ky vit ka qenë monumental për mua", ka shkruar Beyonce në rrjetet sociale.

Sarah të lë gojëhapur me paraqitjen



Ajo e ka betonuar statusin e saj si një ikonë e modës. Kështu që nuk ishte e habitshme që Sarah Jessica Parker i tërhoqi shikimet e të gjithëve me paraqitjen në tapetin e kuq të premierës së

"Here And Now" në Festivalin e Filmit Amerikan në Francë. Aktorja 53-vjeçare u paraqit me një fustan të mrekullueshëm, i cili i vinte në pah linjat trupore të kuruara, pavarësisht prej moshës së saj.



Rita Ora merr sërish vëmendjen edhe në ceremoninë e GQ-së

Rita Ora ka qenë përsëri në qendër të vëmendjes edhe në ceremoninë e "GQ Men of the Year Awards". Këngëtarja shqiptare me famë botërore zakonisht kujdeset që i gjithë fokusi në tepihun e kuq të jetë

tek ajo. Në evenimentin e zhvilluar në Londër, 27-vjeçarja nuk e kishte lënë anash edhe një nuancë provokimi. Fustani që kishte zgjedhur ishte mjaft interesant, ndërsa vinte në pah edhe figurën e saj trupore.

Dasma e Chiera Ferragnit me influencë të jashtëzakonshme

Blogerja e njohur Chiera Ferrangi javën e kaluar kishte ceremoninë e dasmës. Të gjitha mediet dhe njerëzit ishin mahnitur me organizmin si dhe tri fustanet e Dior që ajo kishte zgjedhur për ditën e saj të veçantë. Kjo dasmë u cilësua me më shumë impakt tek njerëzit se ajo e Meghan Markle dhe Princ Harry.



Në vend të in memoriamit

PUNËMBARI BISLIM



**Shkruan: Prof. dr.
Hysen MATOSHI**

Pikërisht në ditën e hapjes së shkollave në Kosovë, më 1 shtator, i mbylli sytë arsimdashësi i madh dhe një ndër intelektualët më të dalluar të Gjilanit e të rrethinës, filologu mr. Bislim Pireva (1946-2018). Gjithë jeta e tij ka qenë e ndërlidhur ngushtë me shkollën, me dijen, me kulturën, me humanizmin. Kushdo e ka njohur dhe ka pasur të bëjë me të ndjeu dhembje për humbjen e një njeriu shembullor dhe profesionisti të rrallë, i cili për gjysmë shekulli në jetën tonë u shqua si pedagog dhe si dijetar.

Profili etik i Bislim Pirevës

Vlera të shumta domethënëse etike e karakterizonin Bislim Pirevën si personalitet i veçantë. Ndër to më kryesorja ishte sakrifica - gatishmëria për t'iu dalë krah të tjerëve, sidomos

atyre që ishin në halle të mëdha. Njeriu, i cili as vetes nuk i jepte kohë të lirë, ishte i gatshëm t'iu kushtonte gjithë vëmendjen familjarëve, kolegëve, miqve, sidomos nxënësve të tij të shumtë, bashkëqytetarëve dhe kujtdo që ishte në vështirësi. Përpjekjet e tij nuk bazoheshin në kurrfarë pushteti e fuqie vepruese që mund të vinte nga mekanizma institucionale a shoqërore. Ato buronin nga parimësia e tij, e cila sakrificën individuale kishte akceptuar si bazë të mjaftueshme për të vepruar në përputhje me kodin e mirësisë njerëzore. Heqja dorë nga të mirat vetjake me qëllim që të ndihmohen të tjerët ishte njëri ndër postulatet e tij etike.

Në sistemin e vlerave të tij ishin edhe modestia dhe qetësia e admirueshme në raport me të tjerët dhe në përballje me situatat e vështira jetësore. Nuk mbante asnjë lloj distance me bashkëkohësit e tij, pavarësisht se cilit rang intelektual e

shoqëror i përkisnin. Afërsia e tij me të gjithë zinte fill nga koncepti që tjetrin ta shihte me respekt dhe ta trajtonte me drejtësi. Nuk mbaj mend ta ketë përçmuar ndokënd, përveç atyre që në prani të tij shiteshin si mendjemëdhenj. Ndaj ishte aq komunikues dhe aq i pranueshëm me të gjithë, pavarësisht nëse bëhej fjalë për të moshuar, për kohanikë të tij, apo për fëmijë. Në debate ishte racional, shterues dhe argumentues. Shumë rrallë ndodhte që, kur nga bashkëbiseduesit kaloheshin të gjithë kufijtë e mirësjelljes, arrogancës t'i përgjigjej me ndonjë shpërthim spontan. Këshilla ishte arma e tij më e fuqishme në komunikim, e cila varësisht nga rrethanat shfaqej në trajtë urtësie e alegorie, por në rastet kur ligjërimi i figurshëm nuk bënte punë ajo vinte edhe si e drejtpërdrejtë.

Përkushtimi ishte një vlerë tjetër etike dhe profesionale e Bislim Pirevës. Në krye të herës ishte një familjar i përkushtuar,


do të thosha shembullor, po aq sa edhe një pedagog i devotshëm në punën e tij me nxënës, një intelektual i fokusuar fuqishëm tek angazhimi për të mirën e përgjithshme shoqërore e kombëtare, një dijetar kërkues i së vërtetës shkencore që rëndom në hulumtimet e tij përfshinte një gamë të gjerë burimesh arkivore, shkrimore e sidomos kujtesën e pavjelë të popullit. Në asnjërin prej këtyre fushave jetësore nuk ishte i rastësishëm, secilës i përkushtohej me tërë qenien e tij, me tërë kapacitetin etik dhe profesional. Në asnjë punë nuk i honepste improvizimet.

Portreti i tij do të vijonte edhe me të tjera vlera, sikundër janë besnikëria, bujaria, guximi, parimësia etj., të cilat besoj se do të shpalosen edhe nga të tjerë kolegë, bashkëkohës, veprimtarë e studiues, të cilët mr. Bislim Pirevën e njohën personalisht, ose edhe nga ata që e njohën veprën e tij të begatë shkrimore.

Studiues me interesime të gjera

Studiues me interesime të gjera albanologjike nga fusha e gjuhësisë, saktësisht dialektologjisë, ku shfaqet si autor që studion një të folme të Gallapit, atë të Jabllanicës së Epërme, pastaj nga fusha e leksikologjisë, si autor fjalorësh, autor i dy monografive për historikun e arsimit shqip të trevës së Medvegjës dhe të trevës së Tygjecit, zë kundërshtues ndaj të pavërtetave që thuhën për shqiptarët, tani së fundmi edhe autor i një libri polemizues me tezat e vjetruara e falsifikuese të historiografisë serbe, por edhe mbledhës dhe botues i trashëgimisë folklorike të Malësisë së Dardanës i monografive e shkrimeve për çështje të ndryshme të trevës, të arsimit, të kulturës, të problematikës teksteve shkollore etj., mr. Bislim Pireva i pati hyrë realizimit të projektit më madhor të të gjithë veprimtarisë së tij intelektuale e profesionale, pro-

PIREVA



përshkrimet e tepruara. Rrjedhimisht teksti i tij është i fokusuar në shpalosjen e konstatimeve, kryesisht nëpërmjet fjalive të shkurtra dhe të qarta. Në kontributet historiografike i përball burimet shqiptare me ato të dijes serbe, pavarësisht që në të shumtën ato vijnë ndesh me përfundimet e tij si autor. Baza më e gjerë burimore e veprës së tij e bën Bislim Pirevën një autor të besueshëm edhe në kontekste përtejkombe të.

Dokumentimi i dhunës shekullore serbe

Pa mohuar kontributin që ka dhënë në fushë të mbledhjes dhe të studimit të lëndës gjuhësore e folklorike të Gallapit, pastaj kontributin e madh historiografik dhënë fillimit dhe zhvillimit të mëpastajmë të arsimimit në këtë trevë, mund të thuhet se fillimi i realizimit të projektit "Dhuna shekullore serbe në Gallap" e shënon ndihmesën monumentale të mr. Bislim Pirevës. Le të themi kryeveprën e tij.

Gjithnjë më ka mahnitur vendosmëria e tij për ta nisur këtë projekt pikërisht duke e njohur përmasën tmerruese të indiferencës sonë kolektive për të kaluarën, pastaj duke e ditur se çdo ditë e kaluar pa faktimin e kujtesës sonë e bën edhe më të vështirë realizimin e projektit, shpërfilljen e paparë institucionale e shoqërore për të mbështetur projektet e kësaj etj.; pra, duke e njohur këtë konglomerat vështirësish nuk isha shumë i bindur se puna e tij do të rezultonte me sukses. Megjithatë, autori i dy vëllimeve - ku fillimisht përfshihen fshatrat Tygjec, Sfirçë, Zajçec dhe Gmicë, ndërsa në vëllimin vijues edhe dyzet fshatra të tjera të Gallapit, në një shtrirje të disa komunave, duke filluar nga Prishtina, për të vijuar me Gjilanin, Artanën, Dardanën, Bujanocin dhe Medvegjën - ka bërë një punë grandioze. Një terren i gjerë, krahas një hapësire kohore me një shtrirje përtejshkullore, nuk kanë qenë pengesë e pakalueshme që mr. Bislim Pireva të sigurojë të dhëna për 1073 shqiptarë të kësaj treve, të cilët në një hark kohor prej më shumë se një shekulli, ose janë ekzekutuar si robër dhe popullsi e pambrojtur nga ekspeditat ndëshkuese serbe, ose kanë rënë në përballje me to, duke mbrojtur kufirin e atdheut etnik. Kjo është një punë kolosale, vështirë e real-

izueshme edhe për ekipe të mëdha studiuesish. Në aspektin metodologjik Bislim Pireva është kujdesur që, në rend të parë, të përfshijë emrat e të vrasësve, kohën dhe vendin e vrasjes, apo të rënies. Në raste të caktuara ka ofruar edhe detaje të tjera, sikundër emrat e vrasësve, ose të njëjste vrastare të pushtuesit, rrethanat në të cilat janë zhvilluar ngjarjet etj.

Mr. Bislim Pireva ka mbledhur dhe ka prezantuar edhe të dhëna që nuk kanë të bëjnë vetëm me jetët e shuara të shqiptarëve të kësaj treve. Në përmasa edhe më të gjera dhuna shekullore serbe shfaqet edhe nëpërmjet torturave fizike e psikike, keqtrajtimeve të rënda e burgosjes, deri te dëbimet masive për në Turqi dhe në vise të tjera shqiptare, gjithnjë me qëllimin që potenciali rezistues kombëtar shqiptar në Gallap të dobësohej, të thyhej kjo barrierë kompakte etnike që ishte bërë pengesë e sllavizmit të Kosovës. Me realizimin e pjesës më të madhe të projektit "Dhuna shekullore serbe në Gallap", mr. Bislim Pireva ua ka ngritur viktimave dhe të rënëve të kësaj treve një lapidar të vogël, por shumë vezullues në ndërgjegjen tonë, një gjurmë të patretshme, e cila, brezat e ardhshëm të studiuesve tanë do të mund t'i shpjerë, në të ardhmen, në rrugën e kërkimit të faktografisë dokumentare arkivore.

Vendlindja dhe Medvegja

Mr. Bislim Pireva ishte ndër të paktët intelektualë të trevës së Gallapit, i cili, pas ngritjes së duhur arsimore-profesionale, dha kontribut edhe për bashkëvendësit e tij. Në aksionin e tij të gjithëmbarshëm arsimor vendlindja përbente një përkushtim të veçantë. Përveçse punoi tri vite në shkollën e vendlindjes, Bislim Pireva u angazhua që të mblidhte dhe të botonte margaritarët popullore folklorikë e leksikografikë të kësaj treve, e cila edhe në këtë



aspekt nuk ishte studiuar sa duhet. Megjithatë, monografia "Shkolla fillore e Tygjecit (1947-2004)" përbën sintezën më të madhe kushtuar historikut të arsimit shqip në këtë trevë, ku janë përfshirë, përveç shkollës amë (të Tygjecit), edhe shkollat e Svirçës, Gmicës, Zajçecit dhe Meshinës. Të dhënat e prezantuar, statistikat, sikundër edhe dëshmitë dokumentare, biografite e mësuesve dhe të personaliteteve të dala nga kjo shkollë, janë të shumta dhe me interes për historikun e shkollës shqipe.

Një trevë shqiptare të cilën mr. Bislim Pireva gjatë gjithë jetës e kishte në vëmendje (pse të mos thuhet edhe në zemrën e tij) ishte Medvegja. Është ndër studiuesit e paktë shqiptarë që ka realizuar dy monografi shkencore, apo më mirë të themi dy sinteza të rëndësishme shkencore për këtë trevë. Monografia "E folmja shqipe e Jabllanicës së Epërme të Medvegjës" përbën kontributin më të rëndësishëm dialektologjik për këtë të folme skajore të shqipes. Citimi i shpesh të saj nga dialektologë shqiptarë është dëshmi vlerave të një pune serioze e të çmueshme kërkimore-shkencore. Monografia tjetër "Shkolla shqipe në Komunën e Medvegjës", e cila për shumëçka është në vazhden e së parës, përbën një sintezë të kronologjisë së ekzistimit të shkollës në Medvegje për më se një shekull. Natyrisht autori e ka qartësuar faktin se shkolla shqipe daton vetëm pas Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë, pasi shkollimi u bë i mundur edhe për shqiptarët e Medvegjës aty nga fundi i shek. XIX (kuptohet në gjuhën serbe), një numër i madh prej tyre u shkolluan, madje edhe i vijuan mësimet në qendra të tjera të kohës, duke shënuar arritje arsimore me interes në përmasën kombëtare. Duke marrë parasysh rrugën zhvillimore të shkollës, ndikimin e saj në jetën e shqiptarëve përgjithësisht dhe kuadrot e shumta që ka

dalë prej saj, mr. Bislim Pireva, me të drejtë, e ka quajtur trevën e Jabllanicës së Epërme një Voskopoje të dytë shqiptare. Të vetëdijshëm për faktin se kjo trevë shqiptare tashmë ndodhet në prag të zhbërjes, mund të themi, me plot të drejtë, se këto dy monografi kanë vlerë të shtuar si kontribute të gjithmonshme shkencore filologjike dhe historiografike.

Të paktë janë njerëzit që zotërojnë një kuantum të përafërt njohurish me ato të mr. Bislim Pirevës për çështjet që ka trajtuar në shkrimet e tij. Gjithë këtë e ka arritur me një punë vetëmohuese dhe të pandërprerë për dekada të tëra. Ndonëse pjesën më të madhe të shkrimeve i ka botuar, jam bindur shumë se informacioni i tij ishte edhe më i gjerë se sa shfaqet në trembëdhjetë botimet që panë dritën për të gjallë të tij. Ishte një enciklopedi e gjallë e trevës dhe një arkiv i saj që ecën nëpër kohë. Përveçse i njihje personalitet e shquara të trevës, ai kishte njohuri madje edhe për pasardhësit e tyre. Duke krijuar një tablo të plotë informacioni, ai krijon edhe premisa të qëndrueshme të argumentimit shkencor.

Të paktë janë njerëzit si Bislim Pireva, të cilët punojnë në heshtje, krijojnë vlera të qëndrueshme, pa i trumbetuar zëshëm ato. Nuk ishte ithtar i përrurimeve të veprave. "Libri i mirë gjithmonë e gjen lexuesin e vet", thoshte. I bindur se puna flet më shumë e më bindshëm për autorin e saj, nuk e kemi parë që t'i propagandonte rezultatet që i kishte arritur me shumë përkushtim e punë të palodhshme. Uroj që trashëgimia e tij, puna shembullore prej pedagogu gjatë më se katër dekadave dhe veprimtaria e tij shkrimore, të shërbejnë për të formësuar profilin e intelektualit mr. Bislim Pireva, por gjithashtu të shërbejnë për brezat e rinj edhe si model i përkushtimit profesional dhe etik.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BLACKPOOL - BRADFORD

1

SUNDERLAND - FLEETWOOD

1

STEVENAGE - MACCLESFIELD

1

Kosova debuton me barazim në Ligën e Kombeve

Kosova, e drejtuar nga Bernard Challandes, ka debutuar me barazim në Ligën e Kombeve, pasi ka mbetur baras me Azerbajxhanin në Baku. Pas tri ditësh "Dardanët" i presin në Prishtinë Ishujt Faroe

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 7 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka debutuar me barazim në Ligën e Kombeve pasi ka luajtur ndaj Azerbajxhanit me rezultat 0-0. Trajneri zviceran Bernard Challandes në këtë mënyrë debuton me barazim në ndeshje zyrtare, pasi në tri ndeshjet miqësore kishte arritur fitore ndaj Madagascarit (1-0), Burkina Fasos (2-0) dhe ndaj Shqipërisë (3-0). "Është një pikë e mirë. Jam i kënaqur. Kemi punuar shumë në mbrojtje dhe bëmë një ndeshje të mirë në aspektin defensivë. Mund të luanim më mirë në sulm, por bëmë shumë pasime të gjata. Ndeshja e parë ishte paksa më e vështirë për Kosovën. Pse njerëzit mendojnë që Rashica duhet të startojë gjithmonë! Ai ka luajtur 10 minuta, por Zhegrova ka luajtur më shumë si në ligë ashtu edhe në Evropa Ligë", ka

thënë pas ndeshjes Bernard Challandes.

Ndeshja u zhvillua në "Baki Olimpiya Stadionu", kurse për ta përcjellë këtë ndeshje ishin mbledhur një numër i vogël shikuesish, derisa ekipi i Kosovës në pjesën e parë luajti mirë duke mos i lejuar shumë hapësira skuadrës kundërshtare e, në anën tjetër, në fund të kësaj pjese rrezikoi dy herë seriozisht portën kundërshtare.

Bersant Celina dhe Vedat Muriqi nuk ishin të saktë në rastet që kishin dhe dyzetepesë minutat e parë përfunduan me rezultat të bardhë. Në pjesën e dytë, Kosova nuk pati ndonjë mundësi të mirë, kurse vendësit rrezikuan dy herë në minutat e fundit, por gjuajtjet e tyre përfunduan jashtë portës së kapitenit Samir Ujkani. Ndërsa rezultati final i ndeshjes ishte 0-0. Duhet cekur se loja në përgjithësi ishte e qetë dhe gjyqtari kryesor e ndëshkoi me karton të verdhë vetëm Hekuran Kryeziun. Pas kësaj pike

të fituar në Baku, Përfaqësuesja e Kosovës më 10 shtator do ta presë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, Ishujt Faroe dhe në këtë ndeshje "Dardanët" presin pikët maksimale.

U21-shat e Kosovës barazojnë me Irlandën

Përfaqësuesja e Kosovës U21 ka barazuar në ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian me Irlandën me rezultat 1-1. Kosova ishte afër t'i gëzohet fitores, por mysafirët arritën ta barazojnë rezultatit pak minuta para fundit të ndeshjes. Pjesa e parë e ndeshjes që u zhvillua në stadiumin "Adem Jashari" në Mitrovicë përfundoi 0-0, kurse Kosova kaloi në epërsi në minutën e 64-t nëpërmjet Florent Hasanit. Irlandezët e barazuan rezultatit në tetë minuta nga fundi me golin e Curtis, kurse ndeshja përfundoi 1-1.

SHKURT

Z Mobile, sponsore e Prishtinës

Kompania vendore e telefonisë mobile, Z Mobile, nga 6 shtatori 2018 do të jetë sponsore e Klubit të Basketbollit Prishtina. Bazuar në marrëveshjen e arritur në mes të dy palëve, klubi më i trofeshëm në basketbollin e Kosovës do të quhet KB Z Mobile Prishtina. "Kompania Z Mobile është e lumtur që do të jetë sponsore e një klubi si Prishtina që, përveç sukseseve në sportin vendor, ka shënuar arritje edhe në garat ndërkombëtare. Z Mobile uron që KB Z Mobile Prishtina të ketë një stinor të suksesshëm dhe të sjellë trofe të tjerë për klubin. Kjo marrëveshje tregon edhe një herë se Z Mobile vazhdon të jetë e përkushtuar ta përkrahë sportin vendor dhe aktivitetet që lidhen me rininë tonë", thuhet në njoftimin e Z Mobile.

Mazrekaj përforcon Ferizajin

Futbollisti i njohur Mentor Mazrekaj është transferimi i ri i skuadrës së Ferizajt. Interesim për ish-lojtarin e Prishtinës kishin shfaqur Flamurtari dhe disa skuadra nga Shqipëria, por ai vendosi ta vazhdojë karrierën në Kosovë. "Mazrekaj së fundmi ishte pjesë e Prishtinës. Ai më parë ka qenë edhe pjesë e Partizanit të Tiranës. Mazrekaj është një sulmues krahu me cilësi të jashtëzakonshme dhe me ardhjen e tij tani jemi të kompletuar dhe të bashkuar vazhdojmë drejt objektivave të klubit", thuhet në njoftimin e Ferizajt.

Snajderi, përshëndetje speciale nga kombëtarja

Mesfushori holandez Wesley Sneijder i ka dhënë lamtumirën Kombëtares së Holandës pas plot 15 vjetësh si protagonist absolut i "tulipanëve". 133 sfida me fanellën portokalli dhe 31 gola të shënuar, por vjen një ditë që edhe futbollistët e mëdhenj duhet të largohen, Sneijder ishte një ndër ta. Ai u largua me kokën lart pasi ka dhënë maksimumin për vendin e tij. Në sfidën e luajtur ndaj Perusë 34-vjeçari mbajti shiritin e kapitenit, teksa në minutën e 62-të u largua nga fusha e lojës mes duartrokitjesh dhe lotësh. Kjo ishte hera e fundit që ai do ta vishte fanellën e kombëtares holandeze. Por largimi i tij u bë në një mënyrë speciale.

Khaka: Shqiptarët festojnë për suksesin tonë dhe të Zvicrës

CYRIH, 7 SHTATOR - Ylli i përfaqësueses zvicerane, Granit Khaka, ka thënë se të gjithë shqiptarët festojnë për suksesin e lojtarëve shqiptarë të Zvicrës. Granit Khaka thekson se pjesë e shoqërisë multikulturore është edhe Zvicra dhe se, pavarësisht se në të ardhmen nuk do ta bëjë gjestin e shqiptonjës dykrenore, ai është i "vetëdijshëm se sa

mijëra shqiptarë qëndrojnë përpara televizorit dhe festojnë singërisht mbi çdo sukses tonin". Këtë deklaratë Khaka e dha në një intervistë për "Luzerner Zeitung", pak ditë pas konferencës së pazakontë, ku deklaroi se "do të ishte budallallëk nëse sërish feston me shqiptonjë". "Ne kishim bisedime interne me të gjithë lojtarët dhe

trajnerin. Më pas vendosëm që: pavarësisht kush kritikohet, ne jemi së bashku, të unifikuar dhe askush nuk mund të na rrëzojë", ka thënë Khaka. Në lidhje me gjestin e shqiptonjës dykrenore, lojtari shqiptar deklaroi se "i gjithë ekipi ishte i habitur me intensionin e diskutimit dhe pasojat pas KB. Nëse bëhet fjalë që kjo erdhi më shumë

nga diskualifikimi zhgënjyes prej Suedisë ose prej gjestit me shqiptonjë, këtë nuk e di". Khaka ka folur edhe për përjashtimin e çuditshëm të Valon Behramit nga përfaqësuesja. "Ai më telefonoi mua dhe të gjithë u habitëm. Valoni ishte një pasqyrë gjigante për mua. Ai na ndihmonte ne të rinjë në kombëtare".

Williams - Osaka, finalja e femrave në US Open

NEW YORK, 7 SHTATOR - Serena Williamsi shuan ëndrrat e Sevastovës dhe kualifikohet për në finalen e turneut "US Open", ku do ta kërkojë titullin e saj të 24-t "Grand Slam" në karriere, si dhe të parin me statusin e nënës. Në ndeshjen me letonezen, ish-

numri një i botës nuk e zgjati shumë dhe iu deshën vetëm 1 orë e 5 minuta lojë për ta thyer kundërshtaren e saj me rezultatin 2-0.

Serena Williamsi i dha mundësinë Sevastovës të fitojë vetëm 3 "game" në këtë ndeshje, ato të setit të parë, të

cilin e mbylli 6-3. Seti i dytë nuk pati histori, me amerikanen që e fitoi pastër 6-0. Kundërshtarja e Serena Williamsit në finale do të jetë japonezja Naomi Osaka, e cila në ndeshjen tjetër gjysmëfinale mendi finalisten e vitit të kaluar Madison Keys, duke

shuar mundësinë për të parë një tjetër finale amerikane në "Flushing Meadows". Osakës iu deshën 1 orë e 25 minuta lojë për ta fituar ndeshjen me rezultatin 2-0. Ajo u shfaq superiore kundrejt Madison Keys dhe i fitoi setet 6-2 dhe 6-4, për t'u bërë e para



teniste nga Japonia që luan finalen e një turneu "Grand Slam".

Keta: Do të flas në ring



DIBËR, 7 SHTATOR - Një ditë para "Duel në themel" sfidës që do të ngjitet në ring boksierin shqiptar Gjetan Keta për titull botëror në peshë të mesme në federatën WBU, është bërë peshimi tradicional i sportistëve. Gjetan Keta do të ndeshet ndaj Sladan Janjanit dhe të dy boksierët peshojnë 71,5 kg. Boksieri shqiptar ka 26 ndeshje, nga të cilat 22 fitore, 18 me k.o dhe vetëm 3 humbje. Ndërsa kundërshtari ka një avantazh në statistika pasi në total numëron 28 ndeshje nga të cilat 25 fitore, 19 me k.o dhe, po ashtu, tri humbje. Gjatë fotografimit, pas peshimit, Janjanin me anë të gjuhës së trupit ka dashur ta tre-

gojë avantazhin e tij në gjatësi, duke u ngritur në majë të gishtave dhe duke parë përtej, provokim i cili është injoruar nga boksieri shqiptar, raporton "Telesport". Ndërsa Ferit Keta me 10 ndeshje, nga të cilat 10 fitore, do të ndeshet me Fatih Mehmet Karakus, i cili në letër ka një avantazh të dukshëm, plot 26 ndeshje, 24 fitore, 13 prej të cilave k.o. Kundërshtari i Ketës peshon 4 kg më tepër, përkatësisht 93 kg, ndërsa Feriti 89 kg. Në konferencën për shtyp, e cila përballë këtë herë nuk kishte vetëm gazetar, por edhe publikun dibran, Gjetan Keta ka dashur të mos flasë para kohe, por fjalën t'ia lë ringut: "Nuk

kam shumë fjalë tani për të thënë sepse dua t'i mbaj për nesër (e shtunë), por unë erdha këtu sepse këtu gjej forcën dhe motivimin për të qenë më i fortë". Ndërsa Sladan Janjanin ka qenë i qartë: "Kam ardhur në Dibër për të fituar, jam gati". Ndërsa ish-kampioni i Evropës, Ferit Keta, ka thënë: "Për mua është kënaqësi të jem në vendlindje, të ndeshem në nder të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti, gjithashtu në Dibër dhe gjithë shqiptarinë. Në mendjen time nuk ngelet gjë tjetër veç fitores dhe sjelljes sportive. Do të doja t'ju falënderoja të gjithëve për mbështetjen!"

Neymari, kapiten i Brazilit

SAO PAULO, 7 SHTATOR - Trajneri i Kombëtares së Brazilit, Tite, ka braktisur përfundimisht formulën e "kapitenit me rotacion", të cilën e ka praktikuar edhe gjatë Botërorit dhe ia ka besuar shiritin yllit brazilian Neymar. Në Rusi shiritin e mbajtën Marcelo dhe Miranda e Thiago Silva nga dy herë secili, ndërsa tashmë përgjegjësia ka kaluar te numri 10 i skuadrës. "Jam kritikuar shumë gjatë Botërorit. Kisha shumë presion, por jam rritur shumë si njeri dhe e ndiej se mund të jem kapiten. Mendoj se kjo përgjegjësi do të më bëjë mirë", ka thënë Neymari. "Jam një lojtar që kur ka njëmbëdhjetë herë topin nën kontroll, arrin ta kalojë kundërshtarin 10 herë. Nuk më lënë të kaloj pa më goditur. Edhe në Rusi më kanë shkakuar shumë faulle, por tani ka kaluar", ka deklaruar Neymari.



SHKURT

Të ardhurat e Realit arrijnë mbi 750 milionë euro

Të ardhurat për periudhën 2017-2018 të klubit të Ligës së Parë të Futbollit të Spanjës (La Liga), Real Madrid, kanë arritur në 750.9 milionë euro. Gjiganti evropian Real Madrid njoftoi tabelën financiare të sezonit të kaluar, sipas së cilës, të ardhurat nga aktivitetet e klubit janë rritur për 11,3 për qind, duke arritur në 750,9 milionë euro. Shifra nuk përfshin të ardhurat e fituara nga transferimet e futbollistëve, ndërsa u shënua rritja më e madhe që nga viti 2000. Më tej, klubi bëri të ditur se sukseset e arritura në turnetë kanë ndihmuar në rritjen e të ardhurave, por bonuset e paguara në këtë periudhë kanë ndikuar në shpenzimet. Gjithashtu, theksohet se klubi mbretëror nuk ka asnjë borxh dhe se ky është sezoni i tretë me radhë të cilin klubi e ka mbyllur me fitim. Real Madridi në korrik të këtij viti lejoi transferimin e Cristiano Ronaldos në Juventus për 100 milionë euro.

"El Clasico" zhvillohet më 28 tetor

Është zbuluar orari i "Ec Clasico"-s së parë në këtë edicion futbollistik. Presidenti i La Ligës, Javier Tebas, ka zbuluar datën dhe orën e ndeshjes më interesante në planet në mes të Barcelonës dhe Real Madridit. Këto dy skuadra do të takohen më 28 tetor në "Camp Nou", nga ora 16:15.

Sarri: Higuaini nuk e tradhtoi Napolin


Trajneri aktual i Chelseat, Maurizio Sarri, ka zbuluar arsyen pse sulmuesi Gonzalo Higuain u largua nga Napoli. Sarri është i bindur se sulmuesi argjentinas nuk e ka tradhtuar Napolin. "Nuk është e vërtetë se Higuaini e tradhtoi Napolin, u largua vetëm për faktin se president ishte De Laurentiis", ka deklaruar Sarri.

Lowi: Ozili më ka dëshpëruar

Trajneri i Gjermanisë, Joachim Low, e ka shprehur dëshpërimin e tij ndaj Mesut Ozilit në nivelin njerëzor pas pensionimit të mesfushorit nga Kombëtarja gjermane. Pas eliminimit nga Kupa e Botës, Ozili vendosi të pensionohet nga Kombëtarja, duke thënë se arsyeja e largimit ka qenë racizmi. "Unë kam pritur nga ai që të më telefonojë dhe do të më tregonte personalisht. Për këtë jam i dëshpëruar. Jam i dëshpëruar me të në nivelin njerëzor. Ne kemi qenë së bashku për shumë vjet. Do ta marr iniciativën përsëri", ka thënë Low.

Modriqi: Ronaldo më uroi për çmimin nga UEFA

Luka Modriq u shpall lojtari i vitit nga UEFA. Ai ishte në këtë garë së bashku me Ronaldon dhe Salah. Ky trofe u kundërshtua nga agjenti i Ronaldos, Mendez. Ky i fundit mendonte se ishte portugezi ai që e meritonte këtë çmim. Pas ndeshjes miqësore në mes të Portugalisë dhe Kroacisë ka qenë vetë Modriq që ka folur për marrëdhënien me Ronaldon. "Kam një raport të mirë me të dhe do të vazhdoj ta kem. Më ka uruar me një mesazh në telefon për trofeun që mora nga UEFA. Gjithashtu më ka thënë se shpreson të takohemi së shpejti. Çmimet individuale janë të bukura, por unë preferoj ato me ekipin, pasi mendoj se grupi është mbi gjithçka", ka thënë Modriq.

		Autor: GAZMEND MORINA	AKTORJA DHE MODELJA AMERIKANE NË FOTO	PASANIKE	KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE ("KALLE MOS TA NIN")	E MITUR	AKTORJA HOLLIVUDIANE COUPE SHTRESË E SIPËR E AJRIT	SUDOKU																		
		NDODHI QË TREGOHEJ ME GOJË; TREGIM ME GOJË (krah.)	○										3										2	6	5	
		E TURPËROJ	○											2			4	5						3		
		BANORE E NJË SHTETI AFRIKAN	○														3							8	9	
		PREZANTUESE E NJOHUR SHQIPTARE	○					FLORI EMBLEMA						5	4			1	7							
		AZOT, URANIUM	○					BASHKËT. FLUTURAKE JASHTËTO-KËSORE		OLIVER NEUVILLE			PJESË E VOGËL MUZIKORE ME KARAKTER LIRIK (shq.)	3	5	9										7
		QË JEP PEMË	○											VRAPIMI MË I GJATË NË ATLETIKË	QYTET NË GJERMANI	ARIANIT (perkdh.)	AKTORJA AMERIKANE PEET	LLOJ LOJE FATI								
ZANORE	○					I JASHTËZ-AKONSHËM, I VEÇANTË QYTET I LASHTË NË ILIRI (shq.)																				
EPOKA E RE	SASI E PRODHIMEVE QË MUND TË NXJERRË NJË FABRIKË	THARTIRA, THARTINA (kim.)	HUNDORËSI, MËNYRË E SHQIPTIMIT ME HUNDË TË TINGUJVË (ling.)	DIÇKA E FITUAR ME PUNË TË PANDERSHME DJALI KUNDREJT PRINDËRVE	LLOJ METALI INTERNATIONAL MARITIME ORGANIZATION			FUTBOLLISTI ITALIAN AMBROSINI "MOLDE"																		
LLOJ BIME NARKOTIKE (shq.)								BISKOTË E GATUAR ME ARRRA (sh.shq.) KLUB I YNI FUTBOLLI																		
FTOHJE E MARRËDHËNIEVE NDËRMJET DY SHTETEVE								DY BASHKËTINGËLLORE			BASKETBOLLISTI TURK OMER SHPIRT I KEQ, DJALL				NEVADA, ARIZONA ATALANTA											
FUTBOLLISTI PERUAN KLAUDIO (WERDER BREMEN)								AKTORI YNË ... ISLAMI AKTORI MORINA			DY BASHKËTINGËLLORE			AUSTRALIAN DESIGN RULES NAIROBI, UGANDA												
MASHKULLI I PARË							QILIM QË SHTROHET NË NJË ANË TË DHOMËS MAKINË GURTHYESE				PJESËTAR I AONËVE PRAROJ			DY ZANORE AKTORI I FAMSHËM HOLLIVUDIAN EDWARD												
KUSH						THIRRMJA E FORTË, KLITHMA DEM						KUMBARË PËRRUA I NGUSHTË DHE I THELLË				JEMENI, ARMENIA	VËLLAI I MADH									
INTENSITET, TITAN						POSEDOJ DIÇKA SHKRONJA TË NJËJTA			ARTERIA MË E MADHE E ZEMRËS AUTORITETI QË KA DIKUSH MBI DIKË					THURJA, QËNDISJA VLERË, DOBI (krah.)												
KATËRKËNDËSH (gjeom.) I SHËMTUAR (krah.)										SHPEND UJI SHTEGTAR SFOND SHKRONJASH			LLOJ PESHKU ILAÇE													
							FUTBOLLISTI HOLANDEZ ... VAN DER MEYDE (shqip.) ANËTARËSIM NË NJË PARTI				EMËR YNI MASHKULLI GJERMAN I VJETËR						ZANORE BASHKËT.									
HISTORIANI ROMAK LUKRECI						EMËR YNI FEMRE SHTETI (huaj)						QË LIDHET ME ORGANIN E TË PARIT QYTET UNIVERSITAR NË ANGLI (shqip. - shq.)												VEGËL MUZIKORE		
EPOKA E RE	REGJISORI ... SOPI	VEGËL MUZIKORE ME FRYMË	AKTORI I FAMSHËM ... MARFI TË LUTEM (fet.)					KAFSHË SHTËPIAKE (shq.) BASHKËT.					QYTET NË FRANÇË (shqip.) QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE (vjet.)				BASHKËT. LLOJ VETURE FRANCEZE									
FUTBOLLISTI ITALIAN IGNAZIO (MILAN)								FILLESTAR GRIMCOVA (bised.)									ALUMIN DEGË E VEPRIMTARI-SË KRUUESE ARTISTIKE									
KAFSHË QË MBAHET NË SHTËPI PËR NGARKESË (shq.) APROVIMI								POETJA JONË AHMETI ILION LIKA							GURRA SHKRONJA TË NJËJTA											
														BISHË MALI SHKRONJA XXIV												
E SHKALLËS MË TË ULËT A E ÇAKUT MË TË POSHTËM																								SHKRONJA XXVIII		

ZGJIDHJA E FJALËKRËQIT: E, MESELE; E, KORIT, GANEZE, AMI, AR, NR, N, S, FRUTOR, O, FENOMENAL, KROM, MASIMO, KANABISI, AMARETAT, AÇARIM, SD, ONAN, NA, PIZARO, ARD, CT, ADR, ADAMI, ANIE, AON, AI, CILI, BRITMA, NUN, ITI, KAM, AORTA, OJA, TETRAON, NOR, KRAF, BETER, ENDI, SABIT, A, TIT, ARDITA, PAMOR, EDI, KALI, REN, F, ABATE, DILETANT, AL, GOMARI, MIMOZA, AMA, MITARIMI, KANA, ARIU, MINIMALE, NITRAT, T. ZGJIDHJA E SUDOKU: Kolona 1: 536 792 481; KII: 812 645 937; KIV: 721 536 894; KV: 695 481 723; KVI: 483 279 516; KVII: 247 863 159; KVIII: 359 127 648; KIX: 168 954 372.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Administracije
Ministry of Public Administration

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L - 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Administratës Publike shpall:

KONKURS

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Divizioni për Buxhet dhe Financa
Titulli i punës : Zyrtar për Buxhet dhe Financa (1 vend pune)
Nr.ref. RN00003685

Kategoria funksionale : Nivel profesional

Koeficienti : 7

Lloji i pozitës : I karrierës

Orët e punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Nëpunës i karrierës (përhershëm) - periudha provuese: dymbëdhjetë (12) muaj

Vendi i punës : Ndërtesa "ish Rilindja", Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës : Sigurimin i zbatimit të politikave, procedurave, standardeve për planifikimin dhe realizimin e buxhetit si dhe praktikave financiare dhe operative të cilat lehtësojnë dhe mbështesin menaxhimin financiar

Nëpunësi raporton te : Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Menaxhon dhe arrin pëlqimin për planin e punës dhe afatet me udhëheqësin dhe stafin tjetër profesional për planifikimin e buxhetit;
2. Merr pjesë në hartimin e planeve vjetore buxhetore të institucionit dhe ndihmon zyrtarët përkatës brenda institucionit për të siguruar që planin të kompletohen me përpikëri dhe sipas afatit;
3. Evidenton faturat për pagesat e projekteve dhe pagesave në regjistrin përkatës dhe kujdeset për procedimin e tyre me kohë për ekzekutimin e pagesës;
4. Kujdeset për plotësimin e obligimeve të organizatës buxhetore duke përfshirë këtu pagesën me kohë e faturave për realizimin e procedurave të prokurimit dhe pagesave ;
5. Bën raportimin ditor në divizionin për buxhet dhe financa për të hyrat e krijuara përmes sistemeve elektronike ;
6. Bën planifikimin e të hyrave;
7. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Shkathtësitë e kërkuara:

- Fakulteti Ekonomik, Administrimin Biznesi apo Kontabilitet;
- Së paku dy (2) vite përvoj pune profesionale;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Njohuri të thell dhe të specializuar në fushën e financave publike dhe buxhetit;
- Njohja e njërës nga gjuhët zyrtare;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Ministria e Administratës Publike/ Zyra e Personelit, ish-ndërtesa e „Rilindja“ kati III (tretë), zyra nr. 320, Prishtinë, Kosovë. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në nr. e tel: 038 / 200-30-002 ose 038 - 200 -30 - 552, prej orës 08:00 - 16:00. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetaret ditore.

- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

- "Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë."

- "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".

- "Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen".

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkojnë për atë vend pune për të cilin konkurren.

- Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e shkurtër do të kontakohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Administracije
Ministry of Public Administration

Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova Zakon. Br. 03/L - 149 i Uredbe Br. 02/2011 god., o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi Republike Kosova, Ministarstvo Javne Uprave objavljuje:

KONKURS

Departman za Finansije i Opšte Usluge
Divizija za Budžet i Finansije
Naziv Rada : Zvaničnik za Budžet i Finansije (1 radno mesto)
Br. ref. RN00003685

Funkcionalna Kategorija: Profesionalni nivo

Koeficijent : 7

Vrsta pozicije : Karijere

Radno vreme : 40 časova nedeljno

Trajanje imenovanja: Zvaničnik karijere (stalni) - probni period: dvanaest (12) meseci

Radno mesto: Zgrada "bivše Rilindje", Priština

Cilj radnog mesta : Osigurati sprovođenje politika, procedura, standarda za planiranje i ostvarivanje budžeta kao i finansijskih i operativnih praksa koja olakšavaju i podržavaju finansijsko menadžiranje.

Zvaničnik izveštava kod: Rukovodilaca Divizije za Budžet i Finansije

Glavni zadaci i odgovornosti:

1. Menadžira i postiže saglasnost za plan rada i rokove sa rukovodiocem i drugim profesionalnom osobljem za planiranje budžeta;
2. Učestvuje u izradi godišnjih planova budžetskih institucija i pomaže relevantnim službenicima unutar institucije da bi se osigurali da se planovi završe na blagovremeni i tačan način;
3. Vodi evidenciju fakture za plaćanje projekata i plaćanja u odgovarajućem registru i vodi računa o njihovoj blagovremenoj obradi za izvršenje plaćanja;
4. Vodi računa o ispunjavanju obaveza budžetske organizacije, uključujući blagovremeno plaćanje računa za izvršavanje postupaka nabavke i uplata;
5. Dnevno izveštavanje u diviziju za budžet i finansije za ostvarene prihode preko elektronskim sistemima;
6. Planiranje prihoda;
7. Izvrši druge zadatke u skladu sa zakonima i propisima koji se mogu s vremena na vreme tražiti od strane supervizora na razuman način;

Potrebne veštine:

- Ekonomski fakultet, Biznis Administracija, Knjigovodstvo;
- Najmanje dve (2) godine profesionalnog iskustva;
- Veštine istraživanja, analiziranja, evaluacije i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
- Duboko i specijalizovano znanje iz oblasti javnih finansija i budžeta;
- Poznavanje jednog od službenih jezika;
- Kompiuterske veštine aplikacionih programa (Word, Excel, Power Point, Access);

Podizanje i dostava aplikacija:

Ministarstvo Javne Uprave / Kancelarija Osoblja, bivša zgrada, "Rilindje" sprat III (treći), kancelarija br. 320, Priština, Kosovo; Za detaljnije informacije možete da kontaktirate sa Kancelarijom za osoblje na tel. br.: 038 / 200-30-002 ili 038 - 200 -30 - 5542, od 08:00 - 16:00 časova. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u jednoj od dnevnih novina.

- Aplikacije poslate poštom, koje imaju pečat o dostavi u pošti do poslednjeg dana konkursa smatraće se važećim i biće uzeta na razmatranje, u koliko dođu u roku od 4 dana, aplikacije koje stignu nakon ovog roka i koje nisu kompletirane neće se razmatrati.

- "Javna Služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje aplikacije iz svih osoba muškog i ženskog svih zajednica na Kosovu."

- "Ne većinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima državne uprave centralne i lokalne javne uprave kako je navedeno u Članu 11. stav 3. Zakona br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republika Kosova."

"Aplikacije dostavljene nakon roka neće biti prihvaćene, a nepotpune aplikacije će biti odbijene."

Uz aplikacije dostavljati kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustva i drugoj potrebnoj dokumentaciji koja je potrebna za to radno mesto za koju konkurišete.

- Samo izabrani kandidati u užem spisku će biti kontaktirani.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin e Punës, Nr. 03/L-212 dhe Rregulloren Nr.05/2011, për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe të Punonjësve Professional të Trashëgimisë Kulturore dhe Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall :

KONKURS

I
Titulli i punës: Arkeolog -1 pozitë
Institucioni: Instituti Arkeologjik i Kosovës-IAK
Vendi: Prishtinë
Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore Grada VIII
Paga: Paga Fikse
Numri i referencës: 39 /2018
I përgjigjet: Drejtorit të Institutit Arkeologjik të Kosovës

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të Institutit Arkeologjik të Kosovës, kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve në fushën e Trashëgimisë Kulturore ;
2. Bashkepunon në menyre të vazhdueshme me Departamentin e Trashëgimisë Kulturore dhe institucionet tjera të Trashëgimisë Kulturore, për realizimin e objektivave të Institutit Arkeologjik të Kosovës ;
3. Kryen detyrat në fushën e Trashëgimisë Kulturore, me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;
5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën e trashëgimisë kulturore, kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushën e arkeologjisë, për shkak të interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
2. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
3. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit ;
4. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
5. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, në shkencat shoqërore, përparësi kanë drejtimet, arkeologji, histori, arkitekturë, minimum 2 vite përvojë pune profesionale.

II
Titulli i punës: Arkeolog -1 pozitë
Institucioni: Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore- Prizren
Vendi: Prizren
Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës dhe Punonjësit Profesional të Trashëgimisë Kulturore Grada VIII
Paga: Paga Fikse
Numri i referencës: 40/2018
I përgjigjet: Drejtorit të QRTK Prizren

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Drejtorit të QRTK Prizren , kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve në fushën e Trashëgimisë Kulturore ;
2. Bashkepunon në menyre të vazhdueshme me Departamentin e Trashëgimisë Kulturore dhe institucionet tjera të Trashëgimisë Kulturore, për realizimin e objektivave të Qendres Rajonale për Trashëgimi Kulturore Prizren ;
3. Kryen detyrat në fushën e Trashëgimisë Kulturore , me një shkallë të arsyeshme të pavarësisë, me mbikëqyrje dhe udhëzime të kohëpaskohshme;
4. Bën hulumtime dhe analiza sipas kërkesës dhe kontribuon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim nga nivelet më të larta;

5. Merr pjesë në grupe punuese në fushën e trashëgimisë kulturore, kur kërkohet një gjë e tillë.
6. Komunikon brenda institucionit dhe jashtë tij për shkëmbim të informatave dhe zhvillimin e punës në fushën e arkitektures për shkak të interesit të përbashkët;
7. Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
8. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

1. Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
2. Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
3. Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit ;
4. Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
5. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
6. Diplomë universitare, në shkencat shoqërore, përparësi kanë drejtimet histori, arkitekturë, arkeologji, minimum 2 vite përvojë pune profesionale.

Procedurat e konkurimit: Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët.

Kohëzgjatja e emërimit: Emërimi është me afat të pacaktuar, pas përfundimit të periudhës provuese gjashtë (6) mujore.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është: 22.09.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Terezë" Nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrat 038 211 921 dhe 038 211 449, apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>

C.nr.115/18

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, Gjyqtari Liridon Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Ultrim/Miftar/Hasani nga Vushtrria, rruga "Lidhja e Lezhës", nr.79, të cilin e përfaqëson me autorizim Mahmut Begu nga Vushtrria, kundër të paditurit Magdalena Marlana Mater, tani me vendbanim të pa njohur në Gjermani, për shkak të zgjedhjes së martesës me shkurorëzim, më datën **03.09.2018**, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **CAKTOHET** përfaqësues i përkohshëm avokati Lirim Perçuku nga Vushtrria, për të ushtruar të gjitha të drejtat dhe detyrat për të paditurin Magdalena Marlana Mater e cila me vendqëndrim është i panjohur në Gjermani, derisa të paraqitet në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi i saj me prokurë.
- II. Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarr të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të paditurit, deri në momentin kur i padituri të paraqitet personalisht në gjykatë, të caktoj të autorizuarin e tij, apo deri në momentin kur organi i kujdestarisë-Qendra për Punë Sociale në Vushtrri, ti caktoj kujdestarin.
- III. **SEANCA** e radhës caktohet me datën 20/09/2018, në ora 09:00 dhe ky komunikim palëve ju shërben në vend të thirrjes së rregullt.
- IV. Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm i bartë pala paditëse.
- V. Ky aktvendim do të publikohet në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës, mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljes të kësaj Gjykate, po ashtu i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, të autorizuarit të paditësit dhe Organit të Kujdestarisë.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË DEGA NË VUSHTRRI,
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.115/18 e datës 03.09.2018

GJYQTARI
Liridon Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në ankesë.



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/ DIVIZION OF HUMAN RESOURCES/ DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazirajući se na Zakon Rada, Br. 03/L-212 i Uredbu br.05/2011, za određivanje Stepna i Plate za Stvaraoce i Izvodače Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleda, i Administrativno Uputstvo (MRSZ) Br.07/2017, o Regulisanju Procedura Konkursa na Javnom Sektoru, Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta objavljuje:

KONKURS

I

Naziv radnog mesta: Arheolog -1 pozicija

Institucija: Arheološki Institut Kosova-AIK

Mesto: Priština

Funkcionalna kategorija: Stvaraoce i Izvodače Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleda Grada VIII

Plata: Fiksna Plata

Broj referencije: 39/2018

Nadležnik: Direktor Arheološkog Instituta Kosova

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora Arheološkog Instituta Kosova, izvršava dole navedene zadatke i odgovornosti:

1. Razija i postiže saglasnost o planovima rada i rokovima sa menadžerom i ostalim profesionalnim stafom, za sprovođenje usluga iz oblasti Kulturne Baštine;
2. U kontinuitetu saraduje sa Departmanom Kulturne Baštine i ostalim institucijama Kulturne Baštine, za realizovanje objekta Arheološkog Instituta Kosova ;
3. Izvršava zadatke iz oblasti kulturne baštine, sa jednim razumnim stepenom samostalnosti, pod nadzorom i uputstvima, s vremena na vreme;
4. Vršiti istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju preporuka za razmatranje, sa najviših nivoa;
5. Učestvuje u radnim grupama rada iz oblasti kulturne baštine, kada se tako nešto zahteva.
6. Komunicira unutar i van institucije za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti arheologije, iz razlogazajedničkog interesa;
7. Redovno izveštava kod nadzornika oko progressa u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične profesionalne oblasti, koji se mogu zahtevati, na razlozan način, s vremena na vreme.

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Duboko i specializovano znanje iz specifične profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitetskog obrazovanja i dotičnih treniranja;
2. Znanje zakona i sprovedljivih pravilnika;
3. Sposobnost u komuniciranju, planiranju i eventualnoj koordinaciji kadrovskog osoblja;
4. Istraživačka, analitička i sposobnost za procenijavanje i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
5. Sposobnost na kompjuteru za aplikacije programa (Word,Excel,Power Point,Access);
6. Univerzitetska diploma u društvenim naukama, prednost imaju pravci istorije, arhitekture, arheologije, minimum 2 godine profesionalnog radnog iskustva.

II

Naziv radnog mesta: Arheolog -1 pozicija

Institucija: Regionalni Centar za Kulturnu Baštine Prizren

Mesto: Prizren

Funkcionalna kategorija: Stvaraoce i Izvodače Kulture i Profesionalnih Radnika Kulturnog Nasleda Grada VIII

Plata: Fiksna Plata

Broj referencije: 40/2018

Nadležnik: Direktor RCKB Prizren

Zadaci i odgovornosti: Pod nadzorom Direktora RCKB Prizren, izvršava dole navedene zadatke i odgovornosti:

1. Razija i postiže saglasnost o planovima rada i rokovima sa menadžerom i ostalim profesionalnim stafom, za sprovođenje usluga iz oblasti Kulturne Baštine;
2. U kontinuitetu saraduje sa Departmanom Kulturne Baštine i ostalim institucijama Kulturne Baštine, za realizovanje objekta Regionalnog Centara za Kulturnu Baštinu- Prizren ;
3. Izvršava zadatke iz oblasti kulturne baštine, sa jednim razumnim stepenom samostalnosti, pod nadzorom i uputstvima, s vremena na vreme;
4. Vršiti istraživanja i analize prema zahtevu i doprinosi u uređenju preporuka za razmatranje, sa najviših nivoa;
5. Učestvuje u radnim grupama rada iz oblasti kulturne baštine, kada se tako nešto zahteva.

6. Komunicira unutar i van institucije za razmenu informacija i razvoj delatnosti iz oblasti arhitekture, iz razlogazajedničkog interesa;
7. Redovno izveštava kod nadzornika oko progressa u vezi prihvaćenih planova rada;
8. Izvršava i svaki drugi zadatak iz specifične profesionalne oblasti, koji se mogu zahtevati, na razlozan način, s vremena na vreme.

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

1. Duboko i specializovano znanje iz specifične profesionalne oblasti, dobijeno preko univerzitetskog obrazovanja i dotičnih treniranja;
2. Znanje zakona i sprovedljivih pravilnika;
3. Sposobnost u komuniciranju, planiranju i eventualnoj koordinaciji kadrovskog osoblja;
4. Istraživačka, analitička i sposobnost za procenijavanje i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
5. Sposobnost na kompjuteru za aplikacije programa (Word,Excel,Power Point,Access);
6. Univerzitetska diploma u društvenim naukama, prednost imaju pravci istorije, arhitekture, arheologije, minimum 2 godine profesionalnog radnog iskustva.

Procedura konkurisanja: Konkurs je otvoren za sve kandidate.

Vremensko trajanje imenovanja: Imenovanje je na neodređeno vreme, nakon šest (6) meseca probnog perioda.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zadnji datum za apliciranje je: 22.09.2018

Aplikacije koje se šalju preko pošte, sa poštanskom markom, na zadnji dan objave, smatraće se važećim.

Podnošenje aplikacije: Aplikacije se uzimaju sa web stranice MKOS-a i predaju se u kancelariji br. 27 u Ministarstvu Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte brojeve tel. 038 211 921 dhe 038 211 449, ili web-stranicu <http://www.mkrs-ks.org/>

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Ariana Haxhija, nga Gjakova shpallë të pavlefshme ID-kartelën e Fakultetit Filologjik drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Frenge në U.P. Prishtinë.

► Gëzime Ismet Shkodra, shpallë të pavlefshme ID-kartelën e Fakultetit AAB, me nr. RE. 2502/14. Prishtinë.

► Ardian Kastrati, shpallë të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të U.P-së, Prishtinë.

► Verona Saramati shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën Kolegji "Mehmet Akif" Prizren.

► Gentiana Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Gani Tac shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shm "Ataturk" Mamusha.

► Leotrim Ibrahim shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën Gymnazium Loyola Prizren.

► Shkumbin Xhafaqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I- VIII dhe VI- IX shf "Dy Dëshmorët" Piranë.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbulë Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet të ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë të jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet të ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhinë. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbropa konvikteve të studentëve, kati VI- lifiti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

Lëshoj shtëpinë me qira, e cila gjendet në lagjen e "Universiteti" përball rrugës B dhe përball marketit Viva Fresh Store. Shtëpia është 100 metra katror dhe e mobiluar. Është e përshtatshme për zyre dhe banim. Numri kontaktues 049-574-169.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom / Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 07.09.2018

Referenca: AAPSK - 006/2018

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Golf IV viti i prodhimit 2000 dizel, ngjyre e gjelbër, me targa vëndore	1 copë	3,000.00€		
2	VW Touran viti i prodhimit 2004 dizel, ngjyre e zeze, me targa te huaja, për auto-pjese	1 copë Auto-pjese	1,200.00€		
3	Opel Astra viti i prodhimit 2006 dizel, ngjyre e zeze, me targa te huaja, për auto-pjese	1 copë Auto-pjese	600.00€		
4	Citroen X Sara Picasso sw viti i prodhimit 2000 dizel, ngjyre e hirit metalike, me targa te huaja, për auto-pjese	1 copë Auto-pjese	300.00€		
5	VW Vento viti i prodhimit 1997, ngjyre e hirit, për auto-pjese	1 copë Auto-pjese	280.00€		
6	VW Golf II viti i prodhimit 1988, dizel ngjyrë e Gjelbër, për skrap	1 copë/për skrap	184.60€		
7	VW Passat viti i prodhimit 1987, benzin ngjyrë e kuqe, për auto-pjese	1 copë Auto-pjese	250.00€		
8	VW Golf II viti i prodhimit 1987, dizel ngjyrë e kuqe, për skrap	1 copë/për skrap	184.60€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 14.09.2018 në ora 10:00h, në lokalet e AAPSK-së, Divizioni i Shitjes (në adresën e poshtëshënuar). Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 12.09.2018, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se, në: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 10:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.



Me Vendimin nr. 2009 të datës 07.09.2018, Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, shpall:

K O N K U R S

Inxhinier i komunikacionit

Numri i pozitave: 1 (një vend pune), kohëzgjatja e kontratës: 1 vit, me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përcjellë qarkullimin e autobusëve në linja, analizon respektimin e orarit dhe propozon ndryshimet e nevojshme tek Udhëheqësi i Transportit.
- Ndihmon në hartim e orarit të qarkullimit për flotën e autobusëve, asiston në plane për transportin dhe analiza të linjave për autobusët e TU-së.
- Analizon aksidentet dhe shkaqet e tyre.
- Përgatitë lëndët e aksidenteve edhe procedon në kompanitë e sigurimeve.
- Ne rastet e veçanta të aksidenteve është i obliguar të dalë në vend të ngjarjes.
- Mbanë evidencën e kilometrave, shpenzimin e karburanteve dhe lubrifikantëve për çdo autobus veç e veç.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Të ketë diplomë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike - Drejtimi i Komunikacionit, me përparësi në nivelin e studimeve Master.
- Njohuri dhe profesionalizëm dhe qasje moderne me ide, hulumtim, planifikim të komunikacionit, përcaktojë itinerarin dhe kushtet e transportit.
- Gatishmëri për të punuar në ndërrim të dytë (14:00-22:00),
- Përvoja e punës në fushën e automjeteve është përparësi.
- Njohja e gjuhës angleze është obligative.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacionin për punësim;
- Kopja e diplomës së shkollimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse ka);
- Kopje të letërnjoftimit;
- Letër motivuese

Mënyra e aplikimit: Kandidati duhet t'i dorëzojë dokumentet e kërkuara në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com

Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga ueb-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>)

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit (08.09.2018 deri më 22.09.2018).



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

